




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
OEVERIA - VLADA - GOVERNMENT



MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA - MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA - POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT - ODELJENJE ZA INSPEKCIJE - DEPARTMENT OF INSPECTION

Referencë: **IPK/02052023/DI**
Datë: **02.05.2023**

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzimin Administrativ (MPB) nr. 21/2015 për Inspektime në Policinë e Kosovës, Rregulloren (MPB) nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzuesin për procedurën e planifikimit, inspektimit e raportimit, Planin Zhvillimor Strategjik të IPK-së (2022-2024), si dhe Planin Vjetor të Inspektimeve të Rregullta, Departamenti i Inspektimeve të IPK-së nxjerrë këtë:

RAPORT I INSPEKTIMIT

Titulli - objekti	- Vlerësimi i performancës së Stacionit Policor të Obiliqit
Referenca	- 02/2023
Data e inicimit	- 21.02.2023
Data e raportimit	- 02.05.2023
Arsyet e inicimit	- Inspektimi në këtë fushë të menaxhimit është paraparë me Planin Vjetor të Inspektimeve të Rregullta (nr. 04-052-108, datë 24.01.2023). IPK ka mandat që të kryejë inspektime në Policinë e Kosovës, për të vlerësuar mënyrën e kryerjes së detyrave. Ky aktivitet ndihmon dhe mbështetë Policinë për të siguruar shërbim profesional, demokratik dhe të përgjegjshëm. Plani Vjetor ka përfshirë kryerjen e inspektimeve në disa fusha të menaxhimit, përfshirë dhe atë të vlerësimit të performancës së stacioneve. Kësaj radhe është filluar me Stacionin Policor në Obiliq me që gjatë vitit të kaluar janë adresuar numër i konsiderueshëm ankesash nën dyshimet se punonjës të tij kanë rënë ndesh me rregullat e sjelljes. Inspektimi paraqet interes për IPK-në, me qëllim që të vlerësohet nëse Stacioni realizon me sukses objektivat në përmbushje të mandatit ligjor, për të krijuar mjedis të sigurt për qytetarët. Inspektimi ofron mundësi për t'u njohur me performancën e Stacionit, me fokus të veçantë në fushat, si: burimet njerëzore, operative, hetimet dhe shërbimet mbështetëse.
Objektivat e inspektimit	- Vlerësimi i organizimit dhe angazhimit të burimeve njerëzore, - Vlerësimi i aktiviteteve operative në ngritjen e nivelit të sigurisë, - Vlerësimi i aktiviteteve hetimore në parandalimin dhe luftimin e krimit, - Vlerësimi i kapaciteteve teknike dhe kushteve të punës.
Metodologjia e inspektimit	- <u>Takime - intervista</u> me gjashtë (6) drejtues dhe bartës të funksioneve: (a) Komandanti i Stacionit Policor, (b) Shefi i Sektorit të Operativës, (c) Shefi i Sektorit të Hetimeve, (d) Shefi i Sektorit të Resurseve, (e) Mbikëqyrësit e ndërrimeve; - <u>Këqyrje - verifikime</u> mbi: sistemin e personelit, prezencën fizike në punë, respektimin e uniformës - dukjes personale, gjendjen e pajisjeve, adresimin e shkeljeve disiplinore, vlerësimin e rezultateve të punës, reagimin në thirrje, llogaridhënie, procedimin e lëndëve, patrullimin, zbatimin e urdhërësave, raportimin e përdorimit të forcës, trajtimin e të arrestuarve dhe të ndaluarve,

	<p>planifikimin, policimin në bashkësi, dosjet penale, kujdesin ndaj dëshmive, funksionalitetin e automjeteve, masat e sigurisë, kushtet teknike, etj.;</p> <ul style="list-style-type: none"> - <u>Marrje dokumentesh</u> fizike/elektronike, si: vendime, kontrata, përshkrime të punës, regjistri i vijueshmërisë, raporte të kontrollit, raporte periodike, dosje disiplinore, raporte të vlerësimit të rezultateve, logu ditor, raporte ditore dhe 24 orë, raporte fillestare të incidentit, orari, dosje kundërvajtjesh, urdhëresa, dosje për përdorim force, dosje të ndalimit, kërkesa për verifikim të kaluarës kriminale, plane operative, pro - forma, raporte mbi policimin në bashkësi, dosje të dhunës në familje, zinxhirë të ruajtjes, regjistra dëshmish, regjistri i qasjes në Dhomë të dëshmive, raporte të kontrollit të dëshmive, raporte mbi automjetet, fletë udhëtime, regjistri i pasurive, plani i evakuimit, etj.
Subjekti	- Stacioni Policor i Obiliqit në kuadër të Drejtorisë Rajonale të Prishtinës
Afatet e inspektimit	<ul style="list-style-type: none"> - Fillimi - 27.02.2023; - Përfundimi - 28.02.2023; - Periudha e mbulimit - dy (2) vitet e fundit dhe gjendja aktuale.
Kriteri vlerësues (standardi)	<ul style="list-style-type: none"> - Kodi Penal i Republikës së Kosovës, - Kodi i Procedurës Penale, - Ligji nr. 04/L-076 për Policinë, - Ligji nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, - Ligji nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, - Ligji nr. 05/L-132 për Automjete, - Ligji nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, - Ligji nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, - UA nr. 01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, - UA nr. 02/2012 për Përdorimin e Forcës nga Zyrtarët Policor, - UA nr. 04/2019 për Shkeljet, Masat dhe Procedurën Disiplinore në PK, - UA nr. 03/2008 për Përdorimin e Automjeteve të Qeverisë së Kosovës, - UA (MI) nr. 01/2018 për Kontrollimin Teknik të Automjeteve, - Rregullore për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës, - Rregullore për Operativë në Policinë e Kosovës, - Rregullore (MF) nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare, - PSO - Koha e reagimit (7 shtator 2018), - PSO - Procedimi i lëndëve dhe kompetencat lëndore të hetimit (25.08.20), - PSO - Sistemet Informative të Policisë së Kosovës, - PSO - Verifikimi i të kaluarës kriminale (22 shkurt 2021), - PSO - Qendrat e Ndalimit në Policinë e Kosovës (1 tetor 2020), - PSO - Hetimi i dhunës familjare (9 gusht 2011), - PSO - Dhomat e dëshmive (15 maj 2014).
Ekipi realizues	<ul style="list-style-type: none"> - Kushtrim Jonuzi, Udhëheqës i Ekipit të inspektimit, - Fitore Gajraku, inspektore, - Mirsad Puqurica, inspektor, - Servet Tasholli, inspektor, - Teuta Rukolli - Ajeti, inspektore, - Xhavit Fetahaj, inspektor.
Mbikëqyrur nga	- Ilir Idrizaj, Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit
Mbështetur nga	- Bujar Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Qasje
Dorëzuar nga	- Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
Miratur nga	- Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së
Datë	- 02.05.2023



Shkurtesat

DTIK	Drejtoria e Teknologjisë Informative dhe Komunikimit
DSP	Drejtoria e Standardeve Profesionale
EDHRT	Ekstremizmi i Dhunshëm dhe Radikalizmi që shpie në Terrorizëm
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
KKSB	Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
KLSP	Komiteti Lokal për Siguri Publike
KPP	Kodi i Procedurës Penale
KPRK	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
KSHPF	Komisioni i Shqyrtimit të Përdorimit të Forcës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
OJQ	Organizata Jo Qeveritare
PSO	Procedura Standarde e Operimit
PUI	Policimi i Udhëhequr nga Inteligjenca
QPS	Qendra për Punë Sociale
QOKR	Qendra Operative Rajonale e Komunikimit
SIPK	Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës
SMIL	Sistemi i Menaxhimit Informativ të Lëndëve

Përmbledhje ekzekutive dhe rekomandimet

Inspektimi nxjerrë në pah se:

- ✚ Nga 15 fusha që kanë pasur fokusin e IPK-së lidhur me burimet njerëzore, janë evidentuar dobësi në çështjet lidhur me funksionalizimin e njërive policore, sistemimin e personelit, regjistrin mbi vijueshmërinë, verifikimin e sigurisë së zyrtarit në bazën e të dhënave, ushtrimin/dokumentimin e kontrolleve të armëve dhe pajisjeve, furnizimin me jelekë dhe sprej kimik, mbajtjen e evidencave mbi trajnimet dhe respektimin e afateve kohore gjatë trajtimit të shkeljeve të lehta disiplinore.
- ✚ Nga 16 fusha që kanë pasur fokusin e IPK-së lidhur me aktivitetin operativ, janë evidentuar dobësi në çështjet lidhur me cilësinë e logut të ngjarjeve ditore dhe dokumentimin e auditimeve lidhur me të, hartimin e planeve që adresojnë shqetësimet e qytetarëve, hartimin e raporteve pas operative dhe veprimet policore në realizimin e urdhëresave të gjykatave (parashkruara).
- ✚ Nga tetë (8) fusha që kanë pasur fokusin e IPK-së lidhur me parandalimin dhe hetimin e krimit, janë evidentuar dobësi në çështjet që lidhen me vlerësimin e rrezikut për viktimat e dhunës në familje, numrin e kufizuar të pyetjeve në intervista dhe të dëshmitarëve potencial, procedimin e rasteve në Prokurori, trajtimin e duhur të dëshmitarëve dhe sistemimin e tyre, trajtimin e sendeve që nuk janë rezultat i konfiskimit/sekuestrimit dhe kontrollin menaxherial në Dhomën e dëshmitarëve.
- ✚ Nga 11 fusha që kanë pasur fokusin e IPK-së lidhur me kushtet teknike të punës dhe të sigurisë, janë evidentuar dobësi në çështjet që lidhen me mungesën e pajisjeve rezervë dhe shtesë në automjete, mbushjen e aparateve kundër zjarrit dhe nivelin e pastërtisë në Qendrën e Ndalimit.



Bazuar në gjetjet, përfundimet dhe nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të shërbimeve:

1. IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit që në koordinim me Drejtorin Rajonal dhe Drejtorin e Personelit, të ndërmarrin veprime në adresimin e çështjeve që lidhen me funksionalizimin e plotë të Strukturës dhe sistemimin e personelit.
2. IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit që të veproj për të siguruar se në kuadër të Stacionit mbahet Regjistër i plotë i vijueshmërisë për gjithë të punësuarit.
3. IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit që të veprojë konform rregullave në fuqi sa i përket Zyrtarit të Bazës së të Dhënave, për t'u siguruar se zbatohen politikat e sigurisë së informacionit dhe se i njëjti plotëson kriterin e pajisjes me Leje të sigurisë.
4. IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit që të shtyjë zyrtarët policor të jenë të pajisur me të gjitha pajisjet e autorizuar, duke e konsideruar kontrollin e vazhdueshëm si një metodë efektive të ushtrimit të mbikëqyrjes.
5. Për arsye sigurie, IPK i rekomandon Drejtorisë së Logjistikës që të përkujdeset në furnizimin e Stacionit me jelek anti-plumb dhe sprej, pasi që për kohë të gjatë ato janë me afat të skaduar.
6. IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit që të ndërmarrë veprimet e nevojshme për t'u siguruar se Sektori i Resurseve mbanë evidenca mbi trajnimet e brendshme dhe të ricertifikimit.
7. IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit që trajtimi i rasteve në nivel Stacioni për shkelje të lehta disiplinore të realizohet brenda afateve të përcaktuara të hetimit dhe vendosjes.

8. *IPK-ja u rekomandon Komandantit të Stacionit, Shefit të Operativës, mbikëqyrësve të ndërrimit që të organizojnë kontrollin të vazhdueshme në Bazën e radio-komunikimit për ngritjen e cilësisë së evidencës së logut operacional.*
9. *IPK-ja i rekomandon menaxhmentit të Stacionit që të hartojë plane operative për parandalimin e luftimit të veprave kriminale, si dhe që adresojnë shqetësime a dukuritë negative brenda shoqërisë, të pasqyruara në raportet vjetore.*
10. *IPK-ja i rekomandon menaxhmentit të Stacionit që gjithnjë pas përfundimit të planeve operative, të analizojë dhe vlerësojë aktivitetet e ndërmarra, sfidat që vështirësojnë arritjen e objektivave të vëna dhe të hartojë raporte pas operative.*
11. *IPK-ja i rekomandon menaxhmentit të Stacionit që të ushtrojë kontroll më efikas mbi zyrtarët policor dhe njësitë, që veprimet fillestare në realizimin e urdhërave të mos jenë të shtyra në kohë, si dhe të shtojnë përpjekjet në marrjen e më shumë veprimeve drejt realizimit të tyre.*
12. *IPK-ja i rekomandon Shefit të Hetimeve dhe hetuesve, të cilët trajtojnë rastet e dhunës në familje, që t'i kushtojnë kujdes më të shtuar "Vlerësimi të rrezikut për viktimën" dhe që ky proces të mos jetë formal, por i mirëfillt dhe i realizuar në bashkëpunim me palët.*
13. *IPK-ja i rekomandon Shefit të Hetimeve që të ushtrojë kontroll të shtuar mbi hetuesit, që gjatë intervistimit të palëve të parashtrajnë numër më të madh të pyetjeve lidhur me rastet dhe në konsultim me Prokurorin e Shtetit, intervistat të përfshijnë edhe dëshmitarë tjerë potencial, që mund t'i kontribuojnë zbardhjes së rasteve. Po ashtu, të ushtrohet mbikëqyrje e duhur edhe në ngritjen cilësore të kallëzimeve penale.*
14. *IPK-ja i rekomandon Sektorit të Hetimeve që nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se një veprë penale është kryer, të dorëzojë kallëzim penal Prokurorit kompetent brenda tridhjetë (30) ditëve pas veprimit të fundit hetimor, i cili vendosë më tutje nëse do të iniciojë procedurën penale (neni 82, paragrafi 5 i KPP-së).*
15. *IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit dhe Shefit të Sektorit të Hetimeve që në drejtim të ushtrimit të kontrollit adekuat mbi lëndët, të respektohet procedura për procedim të rasteve në Prokurori konform Procedurës Standarde të Operimit-Procedimi i lëndëve dhe kompetenca lëndore të hetimit, duke ndjekur rregullin që kallëzimet penale të kalojnë përmes hetuesit të lëndës, tek mbikëqyrësi i vijës së parë dhe më pas tek Shefi i Sektorit të Hetimeve.*
16. *IPK-ja i rekomandon Zyrtarit përgjegjës të Dhomës së dëshmime në kuadër të Stacionit, që me rastin e pranimit të dëshmime nga hetuesit e rasteve, të sigurohet se dëshmitë ruhen në vende të posaçme, varësisht prej specifikave të tyre, me qëllim të ruajtjes nga dëmtimet.*
17. *IPK-ja i rekomandon Zyrtarit përgjegjës të Dhomës së dëshmime që në asnjë rast të mos pranojë/mbajë sende që nuk janë sekuestruar apo konfiskuar konform dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.*
18. *IPK-ja i rekomandon Zyrtarit përgjegjës të Dhomës së dëshmime që të tregojë përkushtimin e nevojshëm në ruajtjen dhe administrimin e duhur të dosjeve që lidhen me dëshmitë, si dhe sistemoj/vendosë dëshmitë në atë mënyrë që ato të jenë lehtë të identifikueshme sipas një sistemi të qartë numerik, të evidentuar në regjistër dhe databazë.*
19. *IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit që në Dhomën e dëshmime të ushtrohen kontrollin të brendshme përmes revizionit, inventarizimit, apo edhe inspektime të pa paralajmëruara, drejt administrimit të duhur të dëshmimeve dhe Dhomës ku ruhen ato.*
20. *IPK-ja i rekomandon Zyrtarit që kujdeset për automjetet, të evidentoj mungesën e pajisjeve rezervë dhe shtesë në automjete zyrtare dhe në koordinim me Drejtorinë e Logjistikës (Flotën Operative), të sigurojnë furnizimin me pajisje e nevojshme.*
21. *IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit që në koordinim me Drejtorinë e Logjistikës të sigurojnë shërbimet e kontraktuar për mbushje e pajisjeve kundër zjarrit, për të siguruar se pajisjet e tilla janë në gjendje funksionale në rast fatkeqësish.*
22. *IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit që në koordinim me shërbimet mbështetëse të Policisë të adresojnë çështjen e pastërtisë, për të krijuar ambient të pastër brenda Qendrës së Ndalimit.*

Faktet kyçe



Zona e përgjithshme e përgjegjësisë

105 km²

Zona e kontrollit për polic

1.8 km²

Raporti polic - banorë¹

1:308



Trendi i krimit (2022)

+8.1%

Numri i veprave penale për polic

7.2

Numri i veprave penale në 1.000 banorë

23.2

Zbulueshmëria e veprave penale (2022)

58%



Koha e përgjithshme e reagimit në thirrje (minuta)

13.86 min

Koha e reagimit në zonë urbane

9.97 min

Koha e reagimit në zonë rurale

17.9 min

Koha e reagimit në rastet e dhunës në familje

15.7 min



Shkalla e ekzekutimit të urdhëresave (2022)

80%

Numri i të arrestuarve për polic (për vit)

0.8

Numri i të ndaluarve për polic (për vit)

0.8



Trendi i patrullimeve në këmbë

+39.1%

Trendi i patrullimeve me automjet

+9.2%

Trendi i pikave të kontrollit

+69.5%



Trendi i gjobave (2022)

-46%

Numri i gjobave në raport me numrin e banorëve

1:6

Numri i policëve në raport me numrin e gjobave

1:46

¹ Sipas Vjetarit Statistikor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, popullsia e vlerësuar e Komunës së Obiliqit më 31 dhjetor 2021 është 17.264 banorë.

Gjetjet kryesore:



1. Organizimi dhe burimet njerëzore

1.1. Elementi më i rëndësishëm i organizatës policore janë burimet e saj njerëzore. Duke konsideruar se paraqesin një vlerë qenësore, shtrohet nevoja për organizimin e mirëfilltë të tyre. Policia është e organizuar bazuar në Ligjin për Policinë, si dhe Rregulloren për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës. Kur jemi tek Stacioni Policor i Obiliqit, IPK-ja ka në fokus organizimin e brendshëm të bazuar në Strukturën organizative të aprovuar më 28.02.2019. Bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës (neni 31), sistemimi dhe transferi i personelit policor, në vendet dhe detyrat e punës, duhet t’iu përshtatet nevojave operacionale dhe Strukturës organizative të Policisë. Kurse, neni 29 i Rregullores për Personel e Administratë në Policinë e Kosovës përcakton se zyrtarët policor, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre i ushtrojnë bazuar në përshkrimet e vendeve të punës për pozitat, në të cilat janë emëruar. Është identifikuar një (1) rast, ku sistemimi i punonjësit në kuadër të Strukturës organizative është përcjellë me mospërputhje pozitë-gradë (Sektori i Operativës parashihet të udhëhiqet nga një toger, por kjo pozitë mbahet nga punonjësi policor me gradë rreshter).

1.2. Sipas nenit 37 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2021, kur nevojat e shërbimit kërkojnë plotësimin e një vendi të lirë, me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, përkohësisht caktohet ushtruesi i detyrës. Gjatë inspektimit nuk janë hasur raste që pozitat në kuadër të Strukturës të ushtrohen me ushtrues detyre.

1.3. Siç u potencua në paragrafin 1.1, sistemimi i personelit në vende të punës duhet t’iu përshtatet nevojave dhe Strukturës. Është hasur në Stacion të ketë punonjës të angazhuar në vende pune, për të cilat nuk janë kompetent, meqë kanë vendime për të punuar në vende tjera pune. Inspektimi vë në pah se dy (2) rreshter që me vendime duhet të udhëheqin sektorët policor, janë sistemuar dhe angazhohen si udhëheqës të njërive reaguese. Ndërsa, një (1) zyrtar policor është sistemuar nga një njësi e Sektorit, në Bazën e të dhënave, për të cilën pozitë kërkohet të ketë verifikim dhe leje sigurie për kryerjen e detyrave (i njëjti nuk ka Leje të sigurisë). Nga radhët e shërbyesve civil nuk ka zyrtarë të pa sistemuar në kuadër të Strukturës organizative.

1.4. Sa i përket funksionalizimit të Strukturës, në Stacion nuk funksionon Zyra për Komunitet dhe Ekipi i Teknikës Kriminalistike. Stacioni edhe pse ka numër më të madh zyrtarësh policor nga ajo që lejohet, nuk ka një sistemim të duhur të tyre dhe nuk arsyetohet mos funksionalizimi i disa prej njërive të parapara me Strukturë. Në Ekipin e Teknikës Kriminalistike ka punuar zyrtari policor me përgatitje e trajnim adekuat, por se i njëjti nuk është aktivizuar në kuadër të Ekipit në fjalë, ngase është sistemuar në njësinë e kujdestarisë. IPK ka analizuar gjendjen e Stacionit me burime njerëzore, duke e krahasuar me Strukturën organizative. Më 31.12.2022, Stacioni ka pasur 63 punonjës edhe pse Struktura parasheh kapacitete prej 56 punonjësish, andaj pasqyrohet tejkalim i burimeve në masën prej 12.5%. Meqë këtë vit është rekrutuar një gjeneratë policësh, Stacioni ka përfituar duke shtuar burimet njerëzore. Stacioni tanimë ka gjithsej 65 punonjës, nga të cilët, 59 të uniformuar dhe gjashtë (6) shërbyes civil, duke tejkaluar kapacitetet e lejuara me Strukturë në masën prej 16%. Kryesisht ka tejkalim të numrit të zyrtarëve të uniformuar dhe mungesë të shërbyesve civil. Në kuadër të Stacionit nuk ka momentalisht Udhëheqës të Sektorit të Resurseve. Në ndërrimin kur është realizuar inspektimi (Ndërrimi 23.00 - 07.00 i datës 27.02.2023), me Plan janë paraparë të angazhohen dhjetë (10) punonjës, por nuk janë hasur dy (2) zyrtarë policor, që kanë munguar për arsye shëndetësore.

1.5. Sipas Rregullores, punonjësi i policisë duhet të paraqitet në detyrë në kohën dhe vendin e caktuar, në detyrat që u janë caktuar me orar paraprak, apo kur kërkohet intervenim i menjëhershëm². Udhëzimi Administrativ mbi Marrëdhënien e Punës

² Rregullorja për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës, neni 15.

në nenin 57 përcakton se punonjësit e punësuar në Polici duhet të vijnë në punë dhe të dalin nga puna me kohë dhe të shkojnë për drekë në kohën e përcaktuar. Ata duhet t'i njoftojnë mbikëqyrësit e tyre të drejtpërdrejtë, nëse janë në dijeni më përpara për rastet, si: kontrollet mjekësore, paraqitja në gjykatë apo raste të tjera, të kërkojnë që ata të mungojnë gjatë orarit të rregullt të punës. Inspektorët kanë qenë në Stacion para fillimit të ndërrimit të orës 07.00 - 15.00 dhe orarit të rregullt 08.00-16.00. Inspektorët kanë siguruar Regjistrin e vijueshmërisë për personelin që ndjekë Orarin e punës 08.00-16.00 (në administratë, hetime dhe sektorë), por jo dhe të ndërrimeve (ekipe reaguese). Sipas mbikëqyrësit të ndërrimit fillimisht sigurohet ardhja në punë e personelit, konfirmohen mungesat dhe më pas hartohet Orari, duke nënkuptuar se Regjistri i vijueshmërisë nuk mbahet, por evidencë mbetet Orari.

1.6. IPK ka verifikuar vijueshmërinë në punë dhe ka krahasuar prezencën fizike me regjistrat. Katër (4) policë të Ekipit intervenues (Ndërrimi 07.00-15.00) kanë ardhur me 20 minuta vonesë dhe për shkak të problemeve të transportit paraprakisht kanë informuar mbikëqyrësit. Siç u tha edhe më lartë, lidhur me vijueshmërinë e këtyre ndërrimeve nuk mbahet Regjistër. Sa i përket vijueshmërisë së personelit me Orar të rregullt të punës (08.00-16.00), Regjistri i vijueshmërisë përputhet me prezencën fizike, por ka pasur dy (2) mungesa, që janë arsyetuar nga mbikëqyrësit, të karakterit shëndetësor e të transportit. Prezenca në punë monitorohet nga menaxhmenti, kurse administrimi i tyre realizohet nga Sektori i Resurseve dhe Operativës.

1.7. Bartja e pajisjeve policore për zyrtarët policor është e rregulluar me Rregulloren për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës. Neni 145 lidhur me pajisjet policore të autorizuar (rripi i uniformës dhe pajisjet që vendosen në rrip) përcakton se punonjësit policor, të cilët kanë autorizime policore, derisa janë në uniformë dhe në kryerje të detyrës, duhet t'i bartin pajisjet, për të cilat janë autorizuar. Në kuadër të kësaj pike janë inspektuar pesë (5) zyrtarë policor dhe rezultatet e inspektimit ad hoc tregojnë se zyrtarët policor janë të pajisur me pistoleta "Glock" me karikatorë dhe me municion të nevojshëm dhe të përcaktuar me rregulla, shufra zyrtare, sprej kimik e pranga. Vetëm njëri nga policët ka prezantuar baterinë (llambën ndriçuese), tre (3) prej tyre nuk i kanë pasur me vete, ndërsa njëri nuk ka qenë i furnizuar me këtë pajisje. Me radiolidhje kanë qenë të pajisur dy (2) nga pesë (5) zyrtarët policor të inspektuar. Rregullorja përcakton bartjen e pajisjeve dhe Stacioni duhet siguruar që zyrtarët t'i kenë me vete ato, e kur ka mungesë të tyre, të sigurohen nga logjistika.

1.8. Përveç pajisjeve policore, IPK ka inspektuar respektimin e standardit të veshjes zyrtare të zyrtarëve policorë. Neni 139 i Rregullores për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës përcakton se si duhet bartur dhe çka përmban uniforma e klasës A (dimërore). Për këtë janë inspektuar pesë (5) zyrtarë policor (përfshirë edhe ato të gjinisë femërore). Sa i përket respektimit të rregullave të veshjes, nga të gjitha pjesët përbërëse të uniformës, vetëm jelekët anti - plumb nuk janë në përdorim, pasi u ka skaduar afati i përdorimit. Sipas zyrtarëve të logjistikës është bërë kërkesa për jelekë dhe presin furnizimin me to. Duhet cekur se në përgjithësi standardi i veshjes së zyrtarëve të inspektuar ka qenë duke u respektuar.

1.9. Dukja personale e zyrtarëve policor është element ndikues meqë përçon imazhin e tyre tek qytetarët. Rregullat mbi dukjen personale janë pasqyruar në nenin 148 të Rregullores për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës. Standardi, i cili është përcaktuar me Rregullore del të jetë respektuar në mënyrë të kënaqshme nga zyrtarët policor të inspektuar në Stacion. Standardi në fjalë është respektuar edhe nga zyrtarët tjerë, të cilët janë hasur gjatë inspektimit.

1.10. IPK në të kaluarën ka rekomanduar që të ushtrohen në vazhdimësi inspektime (kontrolle) të armëve, municioneve, pajisjeve, dhe të hartohen raporte përkatëse, me qëllim që të avancohen standardet unike të punës në menaxhimin efikas dhe efektiv të burimeve. Në Stacion janë kërkuar raporte të inspektimeve, të realizuara nga ana e menaxherëve. Gjatë këtij viti nuk është bërë asnjë inspektim i kësaj natyre. Gjatë

vitit 2022, inspektimi i fundit është realizuar në muajin shtator. Rezulton se në një periudhë të gjatë kohore nuk ka pasur kontrolle apo inspektime të mjaftueshme të armëve, municioneve dhe pajisjeve. Menaxherët duhet të jenë më të kujdesshëm në realizimin e inspektimeve të tilla. Bazuar në raportet e kaluar, inspektime zakonisht janë realizuar nga shefat e njësisve. Në të ardhmen duhet hartuar plane për kontrolle më të shpeshta, ku duhet të përfshihen edhe drejtuesit apo mbikëqyrësit. Nga këto kontrolle të mbahen shënime dhe të përpilohen raporte të hollësishme për gjendjen.

1.11. Rregullorja për Operativë në Policinë e Kosovës përcakton që zyrtari policor duhet të përkujdeset që armën zyrtare ta mbajë dhe mirëmbajë në gjendje të rregullt. Zyrtari policor, pa marrë parasysh a është në kryerje të detyrës, apo jo është i obliguar që armën zyrtare ta mbajë të pastër e në gjendje të rregullt për përdorim. IPK-ja ka inspektuar ad hoc pesë (5) zyrtarë policor, për të parë se sa ata janë të kujdesshëm dhe mirëmbajnë armët e pajisjet, përfshirë dhe municionin. Pistoletat kanë rezultuar të pastra. Spreji kimik dhe jelekët anti - plumb janë hasur me afat të skaduar. Fishekët janë ndërruar këtë vit dhe janë zyrtar. Sa i përket sprejit kimik, duhet pasur parasysh se përdorimi eventual i tyre mund të ndikojë në shëndetin e personave, me të cilët mund të ketë ballafaqim.

1.12. Bazuar në nenin 100 të Rregullores për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës, përcaktohet se njësitë organizative në kuadër të Policisë, divizionet, drejtoritë në Departamentin për Shërbime Mbështetëse, Drejtoritë Rajonale duhet të përkujdesen që secili zyrtar policor i kësaj drejtorie, brenda periudhës kohore prej një (1) viti t'i mbajë së paku 40 orë trajnimi (përfshirë dhe certifikimin). Lidhur me trajnimet e avancimin profesional të zyrtarëve policor të Stacionit, IPK ka kërkuar të dhëna mbi përfshirjen e zyrtarëve policor në trajnime të brendshme, por që i njëjti nuk ka qenë në gjendje të pasqyrojë të dhëna mbi aktivitetet e tilla.

1.13. Rregullorja në nenin 114 parasheh që gjithë zyrtarët policor, pa marrë parasysh nivelin dhe gradën policore, janë të obliguar që brenda periudhës kohore prej çdo 12 deri në 18 muaj ta vijojnë trajnimin për ricertifikim. Ricertifikimi ka për qëllim që të gjithë zyrtarët policorë, përmes këtij procesi t'i ri përsërisin dhe t'i rifreskojnë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre policore, në mënyrë që të jenë sa më efikas dhe profesional në kryerjen e punëve policore. Mungesës së të dhënave të mjaftueshme nga Stacioni lidhur me trajnimet i shtohet edhe ai mbi ricertifikimin. Ricertifikimi i fundit në këtë Stacion është kryer në vitin 2021 për 33 zyrtarë policor. Përgjithësisht informatat e siguruar mbi ricertifikimin janë të mangëta dhe mungesa e tyre rezulton nga mungesa e Zyrtarit përgjegjës për Resurse.

1.14. Bazuar në rregullat në fuqi, stacionet trajtojnë shkeljet e lehta disiplinore që u drejtohen nga autoriteti kompetent policor (DSP-ja). Kjo fushë është rregulluar me Udhëzimin Administrativ nr. 04/2019 për Shkeljet, Masat e Procedurën Disiplinore në Policinë e Kosovës. Bazuar në nenin 13, nëse shkeljet bëjnë pjesë në kategorinë e shkeljeve të lehta disiplinore, hetimet fillojnë dhe përfundojnë në nivel lokal sipas kategorisë së shkeljeve të lehta. IPK ka siguruar tre (3) kopje të rasteve të trajtuara në Stacion (0284-HBNL-2021, 0501-HBNL-2021, 0304-HBNL-2022). Lëndët janë vlerësuar nga aspekti i respektimit të rregullave e procedurave konform akteve për shkeljet e lehta disiplinore. Sa i përket epilogut të tyre, lëndët janë mbyllur në nivel Stacioni në mungesë të provave për shkelje të lehta. Mostrat përmbajnë njoftimet për palët, vendimet, deklaratat dhe raportet përfundimtare. Afatet e hetimit nuk janë respektuar sipas Udhëzimit³. Hetimet në nivel lokal për shkeljet e lehta disiplinore mund të zgjasin deri në 30 ditë. Rasti nr. 0284-HBNL-2021 është pranuar me datën 16.07.2021 dhe ka përfunduar më 23.11.2021, rasti 0501-HBNL-2021 është pranuar më 12.11.2021 dhe ka përfunduar më 11.02.2022 dhe rasti nr. 0304-HBNL-2022 është pranuar më 23.09.2022 dhe ka përfunduar më 07.11.2022. Në këto raste ka

³ Neni 69, paragrafi 12 i Udhëzimit.

tejkalim të afateve të përcaktuar me Udhëzim. Përveç kësaj janë hasur dobësi në shënimin e datave të sakta se kur ka ardhur dhe filluar rasti të hetohet. Si shembull pasqyrohet rasti me nr. 0501-HBNL-2021, i cili është pranuar më 12.11.2021, kurse në shkresa ceket se hetimi ka filluar më 21.10.2021, d.m.th një muaj para se rasti të vijë në Stacion. Dobësi të tilla vërehen edhe në dy rastet tjera. Kjo është neglizhencë dhe jo profesionalizëm nga zyrtarët që trajtojnë rastet dhe duhet kushtuar kujdes shënimin të saktë të datave dhe kohës në shkresa.

1.15. Për kryerjen e detyrave gjatë punës, menaxherët dhe drejtuesit janë të detyruar të vlerësojnë rezultatet në punë, të njohur si vlerësim performance. Bazuar në nenin 79 të Udhëzimit Administrativ mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, punonjësit e Policisë lidhur me kryerjen e detyrave të punës i nënshtrohen vlerësimit periodik të performancës që ka për qëllim rritjen e cilësisë në punë dhe përmirësimin apo avancimin gradual të aftësisë profesionale të punonjësit. Sipas PSO-së, Policia, respektivisht mbikëqyrësi ku punonjësi punon, është i obliguar që së paku një herë në vit ta bëjë vlerësimin e performancës për punonjësin, që është nën mbikëqyrjen e tij. Lidhur me këtë, IPK ka marrë gjashtë (6) mostra të vlerësimit të performancës (1 për toger, 2 për rreshterët dhe 3 për zyrtarët policor). Vlerësimi i performancës është bërë sipas formularit standard dhe është realizuar brenda afatit. Nga vlerësimet e siguruara, një (1) toger ka shfaqur pakënaqësi dhe është ankuar kundrejt vlerësimit me pretendimin se është i pabazuar dhe jo real.

2. Aktivitetet operative

2.1. Logu ditor është pasqyrë e krijuar elektronike apo me shkrim, në të cilën duhet të evidentohen informimet telefonike zyrtare të pranuar, nga cilido informues i mundshëm, për një rast apo ngjarje të caktuar të ndodhur më parë apo që është në zhvillim e sipër dhe po ashtu në Log evidentohen dhe të gjitha informatat e pranuar në mënyra tjera të informimit, për të cilat vlerësohen se janë të rëndësishme së veçantë. Në Raportin e inspektimit “Menaxhimi i thirrjeve dhe reagimit policor”, i dalur nga inspektimi i realizuar në të gjitha stacionet është pasqyruar se janë hasur dobësi në mbajtjen e logjeve operationale, andaj IPK-ja u ka rekomanduar komandantëve të stacioneve, shefave të operativës dhe mbikëqyrësve të ndërrimeve, që të ushtrojnë kontrole të shtuara, përfshirë auditimet e planifikuara periodike mbi zyrtarët që mbajnë logjet, drejt ngritjes së cilësisë së evidencës. IPK-ja ka siguruar logjet e tre muajve të fundit të Stacionit, për t’u siguruar se evidenca është cilësore, përditësuar me të dhëna mbi thirrjet e reagimit. Logu mbahet nga Zyrtari i radio-komunikimit dhe sipas drejtuesve, ai auditohet kohë pas kohe por që nuk është dokumentuar se kryhet ky aktivitet. Kontrolli i logut vë në pah se për një numër thirrjesh nuk ka të dhëna mbi kohën e reagimit të patrullave në vendngjarje.

2.2. PSO përcakton që koha e reagimit për zonat urbane të jetë maksimum 15 minuta dhe për zonën rurale, maksimum 30 minuta, varësisht lokacionit ku ndodh rasti (me përjashtim në disa zona të thella malore e me kushte të papërshtatshme atmosferike). IPK-ja ka pasur fokus reagimit policor në thirrjet e qytetarëve dhe për të konstatuar efektivitetin e njësive policore janë kontrolluar 265 mostra të ngjarjeve ku ka pasur reagim policor⁴. Në matjet e vitit të kaluar, koha e përgjithshme mesatare e reagimit për të gjitha stacionet ka qenë 13.76 minuta, kurse Stacioni në Obiliq atë kohë ka pasur një performancë në nivel të mesatares së përgjithshme (14.16 m). Inspektimi i fundit me mostra të muajve dhjetor, janar dhe shkurt pasqyron se koha e reagimit është shkurtuar nga 14.16, në 13.86 minuta, kohë që është në nivel të mesatares së përgjithshme të reagimit të stacioneve. Inspektimi i vitit të kaluar ka pasqyruar se ky Stacion ka pasur një kohë të shkurtër të ndarjes së detyrës të patrullat policore

⁴ Koha e reagimit llogaritet nga pranimi i informatës nga QOKR, mbikëqyrësi, apo Policia në ndonjërin nga format e komunikimit, koha e dhënies së informatës tek patrulla apo njësi që ngarkohet, koha e nisjes së patrullës/ njësisë së ngarkuar dhe arritja në vendngjarje.

(1.82 minuta) krahasuar me mesataren e përgjithshme për të gjitha stacionet (2.15 minuta). Stacioni vazhdon të ketë kohë gati se të njëjtë me atë të matur nga viti i kaluar (1.89 minuta). Nga viti i kaluar, Stacioni ka ulur kohën e reagimit në zonën urbane afërsisht për 1 minutë (nga 10.79, në 9.97 m), derisa në zonën rurale, koha mbetet e njëjtë (nga 17.68 në 17.97 m). Raporti në përqindje ndërmjet reagimit me kohë të Stacionit dhe reagimit me vonesë gjatë vitit të kaluar ka qenë 83:17, më i kënaqshëm se raporti i përgjithshëm në nivel të stacioneve (80:20). Ky raport në këtë vit ka vazhduar të ketë trend pozitiv, duke reduktuar vonesat (84:16).

2.3. Bazuar në nenet 29, 30, 31 dhe 32 të Rregullores për Personel dhe Administratë, policët, rreshterët, togerët, si dhe kapitenët kanë përgjegjësi të raportimit, varësisht pozitive menaxhuese. IPK ka verifikuar nëse zyrtarët e Stacionit kryejnë raportimet e nevojshme sipas detyrave të parapara dhe nëse ato kryhen me kohë. Fillimisht janë siguruar raportet e patrullave mbi ngjarjet në ndërrimet e fundit, ku janë përfshirë fletë patrullat dhe Raporti 24 orë i situatës ditore (26.02.2023). Fokus i inspektimit ka qenë edhe verifikimi i kohës së përpilimit të raporteve. Bazuar në këtë, janë kontrolluar raportet ditore të ndërrimeve të pesë (5) ditëve të fundit, Raporti 24 orë në nivel stacioni dhe raportet javore/mujore dhe vjetore (2021/2022). Për aktivitetet ditore, zyrtarët policor përpilojnë raporte për detyrat e realizuara të ndërrimit (fletë patrulla), që inspektohen nga mbikëqyrësit dhe bëhen pjesë e Raportit 24 orësh në nivel stacioni. Sektori i Operativës ka prezantuar raporte për aktivitete ditore, derisa ai i Hetimeve dhe i Administratës nuk praktikojnë një gjë të tillë. Raportet periodike të punës përpilohen në vazhdimësi. Informatat nga këto raporte më pas përmbledhen në raportet vjetore në nivel Stacioni.

2.4. IPK ka përcjellë rrugëtimin e rasteve deri tek njësitë kompetente që vazhdojnë me trajtimin e tyre. Sipas PSO-së, është obligim dhe detyrë e njësitit patrullues të kompletojë rastin e raportuar brenda zonës së përgjegjësisë dhe më pas t'ia dorëzoj shefit të ndërrimit për kontroll dhe nënshkrim. Rasti duhet të dorëzohet nga njësitit i patrullës sa më parë që është e mundur e më së voni deri në përfundimin e orarit të punës. Rasti regjistrohet në Librin e rasteve në Zyrën e bazës së Stacionit (në mënyrë elektronike dhe fizike). Përveç rasteve urgjente, rastet që iniciohen brenda 24 orëve (brenda tre ndërrimeve), çdo ditë (përfshirë vikendit dhe festave) në orën 08.30 të mëngjesit dorëzohen në Sektorin e Operativës, të cilët kontrollohen nga Shefi i Operativës se a janë kompletuar sipas procedurave të parapara dhe a janë në pajtim me KPRK, KPP dhe ligjet tjera në fuqi. Nëse rasti është i kompletuar, i dërgohet Komandantit apo zëvendësuesit të tij për nënshkrim. Pas nënshkrimit, rastet më pas merren nga zyrtari i SIPK, fotokopjohen dhe një kopje mbetet në arkiv (data bazë), kurse origjinali i dërgohet Njësisë së Hetimeve jo më vonë se në orën 09.00 për çdo ditë pune. Lidhur me procedimin e lëndëve, janë inspektuar pesë mostra me raport fillestar të incidentit dhe rezultoi se në të gjitha rastet ato janë proceduar përmes zinxhirit komandues brenda afatit 24 orësh dhe janë regjistruar në evidencë fizike dhe në SIPK. Një (1) rast është proceduar i pa nënshkruar nga Komandanti i Stacionit (2023-AJ-0053).

2.5. Patrullimet janë aktivitete që realizojnë stacionet në drejtim të krijimit të një mjedisi të sigurt për qytetarët. Sipas nenit 3 të Rregullores për Operativë, patrullimi është veprim policor, përmes të cilit mbahet rendi dhe qetësia publike, sigurohet prona, lëvizja e lirë, kontrolli i kufirit, rregullimi i trafikut, parandalimi dhe zbulimi i veprave penale, kapja e kryesve të veprave penale, si dhe veprime të aktivitete tjera nga fusha e sigurisë, të cilat bëhen nga Policia në zbatim të ligjit. IPK ka verifikuar prezencën e patrullave në orët e hershme të mëngjesit të datës 27.02.2023, para dorëzimit të ndërrimit 23.00 - 07.00. Fillimisht është siguruar Orari ditor i Stacionit dhe me prezencën e Mbikëqyrësit të ndërrimit (AK-10) janë vizituar patrullat e shpërndara nëpër terren. Dy (2) patrulla policore me nga dy (2) zyrtarë policor janë hasur në lokacionet e përcaktuara me Orar (AK-101 dhe AK-102). Njëra patrullë është hasur në pikë kontrolli në hyrje të qytetit, kurse tjetra në lëvizje nëpër qytet.

2.6. Patrullat kryejnë patrullime me automjete dhe në këmbë, por organizojnë edhe pika të kontrollit. Në trafik shkaktohen kundërvajtje, për të cilat stacionet shqiptojnë gjoba në drejtim të ngritjes së sigurisë në rrugë. Neni 10 i Rregullores për Operativë përcakton që ndalja e automjetit për shkak të kundërvajtjes në trafik apo për qëllime tjera, në të shumtën e rasteve konsiderohet si detyrë e rregullt e zyrtarëve policor patrullues. Realizimi i patrullimit dhe pikë kontrollit varet nga një sërë faktorësh dhe nuk ka një metodologji të caktuar se si duhet kombinuar këto aktivitete. Ka një ngritje të numrit të patrullimeve në këmbë në vitin 2022 për 39%, krahasuar me një vit më parë dhe realizimi mesatar ditor prej dhjetë (10) patrullime në këmbë renditë Stacionin mbi mesataren e përgjithshme të stacioneve që është katër (4) patrullime. Ka shtim patrullimesh me automjet për 9%, por realizimi mesatar ditor prej dy (2) patrullimeve me automjet e renditë stacionin më poshtë mesatares së përgjithshme që është shtatë (7) patrullime. Edhe pikat e kontrollit kanë shënuar ngritje për 70% krahasuar me një vit më parë dhe realizimi mesatar ditor prej tetë (8) pika kontrolli renditë Stacionin në nivel me mesataren e përgjithshme të stacioneve që është gjithashtu tetë (8) pika kontrolli. Ajo që bie në sy është rënia drastike e numrit të gjobave në vitin 2022 që shënon një rënie për 46% krahasuar me vitin paraprak. Përgjatë vitit të fundit, një polic i Stacionit ka shqiptuar afërsisht 48 gjoba, derisa mesatarja e përgjithshme për stacione ka arritur në 98 gjoba për polic gjatë vitit.

2.7. IPK-ja është interesuar të njihet me funksionimin e SIPK-ut dhe procedurën e evidentimit të kundërvajtësve për shqiptim të masës mbrojtëse, pikëve negative dhe regjistrimin në evidencë fizike. Përderisa për dhjetë (10) mostrat e inspektuara të kundërvajtjeve është gjetur se masat mbrojtëse, pikët negative dhe gjobat futen me kohë në SIPK, shënimet në evidencë fizike regjistrohen me vonesë dhe ka shkëputje në raport me atë elektronik. IPK udhëzon që krahas aplikimit të sistemit elektronik, të mbahen shënime edhe fizikisht. Sa i përket rregullave mbi konfiskimin e patentë shoferëve me masë mbrojtëse dhe pikë negative, në gjitha dosjet e kontrolluara, patentë shoferët kanë qenë të bashkëngjitur. Praktika e mëparshme për konfiskim të patentë shoferëve nuk ka ndryshuar edhe pse rreth kësaj çështjeje, IPK ka përpiluar në të kaluarën raporte me rekomandime.

2.8. Puna policore në masë të madhe lidhet me parandalimin, hetimin dhe zbulimin e krimit, andaj Policia ndërmer veprime hetimore dhe masa të nevojshme që të zbulojë veprat penale dhe të kapë kryesit e tyre. Policia vepron edhe në realizimin e urdhëresave të gjykatave dhe organet e drejtësisë ngarkojnë atë që të sjellë para tyre të dyshuarit/të dënuarit, që mund të lidhen me vepra të ndryshme penale, apo kundërvajtje. Kjo rregullohet me Kodin e Procedurës Penale, Ligjin për Ekzekutim të Sanksioneve Penale, Ligjin e Policisë dhe me PSO. Policia pranon numër të madh urdhëresash, përfshirë urdhër arreste, letër rreshtime e urdhëresa me burg. Stacioni angazhohet në ekzekutimin e urdhëresave dhe ka kuotën e realizimit në masën mbi 80% për të dy vitet ndaras, që është mbi mesataren e përgjithshme të stacioneve. Afërsisht 4/5 e urdhëresave janë ekzekutuar nga Stacioni gjatë një viti, krahasuar me mesataren e përgjithshme që pasqyron se stacionet kanë ekzekutuar afërsisht 3/4 e urdhëresave brenda viti. Gjatë dy viteve të fundit ka pasur performancë të dalluar krahasuar me mesataren e përgjithshme edhe sa i përket lëndëve të parashkruara dhe të mbetura. Sa i përket ngarkesës me lëndë, Stacioni ka ngarkesë më të ulët për polic krahasuar me mesataren e përgjithshme. Kur analizohet efektiviteti i realizimit të urdhëresave për polic, del se një i tillë nga Stacioni ka realizuar 83%, përkatësisht 80% të urdhëresave, me të cilat është ngarkuar, krahasuar me mesataren e përgjithshme ku një polic ka ekzekutuar 73%, përkatësisht 76% të urdhëresave, me të cilat është ngarkuar, varësisht prej vitit.

2.9. Në kuadër të detyrave, zyrtarët policor merren me realizimin e urdhëresave të gjykatave për vepra të ndryshme penale, përfshirë urdhëresat për ekzekutim dënimi (me burg), urdhër arreste (365 ditë), letër rreshtime, urdhëresa për kohë të caktuar

(për paraqitje në seanca gjyqësore), urdhëresa për mbikëqyrjen e masave të arrestit shtëpiak dhe urdhëresa tjera. Nga dhjetë (10) dosjet e kontrolluara me urdhër arreste në kohë zgjatje 365 ditë, të cilat janë parashkruar (revokuar), IPK-ja është interesuar për veprimet e ndërmarra në realizimin e tyre. Në të gjitha mostrat rezultojnë se janë ndërmarrë veprime në drejtim të realizimit të tyre, por jo më shumë se një për rast. Te rastet e parashkruara, koha mesatare deri në veprimin e parë të realizimit të urdhëresave është 36 ditë, përfshirë periudhën nga data e lëshimit. Numri i vogël i veprimeve për kërkimin e personave me urdhër arrest të këto raste, përveç që në të shumtën e rasteve rezultojnë me mos gjetjen e tyre, mund të ketë për pasojë edhe revokimin e urdhëresave.

2.10. IPK është interesuar dhe për përditësimin dhe shlyerjen e urdhëresave me kohë nga SIPK, dhe për këtë janë inspektuar pesë (5) dosje, të cilave u ka kaluar afati 365 nga dita e lëshimit nga Gjykata. Nga inspektimet e kaluara është pasqyruar se një numër stacionesh kanë aplikuar heqjen e urdhër arresteve nga SIPK-u, nga momenti kur skadon afati 365 ditë, ndërsa disa të tjera, tërheqjen e kanë praktikuar pasi të kenë pranuar shkresat mbi revokim (tërheqjen) nga Gjykata. Pas skadimit të afatit 365 ditë të urdhër arresteve, ose të revokimit të tyre, Stacioni në Obiliq shlyen me kohë ato nga SIPK-u.

2.11. Ligji për Policinë rregullon fushën e përdorimit të forcës dhe armës së zjarrit nga zyrtarët policor, të cilët janë të autorizuar të përdorin forcë, vetëm atëherë kur është e domosdoshme dhe vetëm deri në nivelin që kërkohet për t'i arritur objektivat legjitime të Policisë. Udhëzimi Administrativ nr. 04/2019 për Përdorimin e Forcës nga Zyrtarët Policor parasheh raportimin e zyrtarit policor në rastet kur ai përdorë forcën fizike. Fokusi i IPK-së në drejtim të këtij objekti është raportimi në rastet e përdorimit të forcës. Nga gjashtë (6) dosjet e inspektuara me përdorim të forcës nga zyrtarët policor të Stacionit Policor të Obiliqit, rezultojnë se në gjitha rastet është plotësuar formulari për përdorim të forcës dhe dosjet kanë njoftimet drejtuar Drejtorisë Rajonale. Asnjëri prej këtyre mostrave nuk ka të bashkëngjitur Raportin nga KSHPF dhe IPK-se iu ka pamundësuar dhënia e opinionit mbi implementimin e rekomandimeve të këtij autoriteti, nëse ka pasur.

2.12. Detyrë e Policisë është të mbrojtë jetën, pronën, të ofrojë siguri për të gjithë personat, të mbrojtë liritë e të drejtat themelore të të gjithë personave, të parandalojë dhe zbulojë veprat penale dhe kryesit e tyre, si dhe detyra tjera të parapara me ligj. Gjatë punës së saj operative, Policia ndalon persona, të cilët i mbanë në qendrat e ndalimit, por të cilëve duhet t'u respektohen disa të drejta. Prokurori i Shtetit lëshon Aktvendim, për të caktuar masën e ndalimit për periudhën 24/48 orë dhe në bazë të së cilit, zyrtarët policor në qendra të ndalimit, i pranojnë personat e arrestuar aty. I ndaluarit duhet të njoftohet menjëherë nga momenti i vënies në dijeni mbi arsyet e arrestit të përcaktuar në nenin 167 të KPP-së. Sipas nenit 169, i arrestuari ka të drejtë që sipas kërkesës së tij të kontrollohet nga mjeku ose dentisti, sipas zgjedhjes së tij, sa më shpejtë që të jetë e mundur pas arrestimit të tij dhe në çdo kohë gjatë ndalimit. Koha e ndalimit policor të të dyshuarve të mundshëm nuk duhet të kalojë më shumë se 48 orë nga koha e arrestimit, përveç rasteve kur Gjyqtari i Procedurës Paraprake urdhëron ndryshe, respektivisht sipas nenit 65 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, ndalimi i të miturit nuk mund të kalojë periudhën 24 orë, pas kalimit të kësaj periudhe. IPK-ja ka kontrolluar pesë (5) dosje të ndalimit prej të cilave kuptohet se në të gjitha rastet ka pasur aktvendime mbi ndalimin, të arrestuarit janë njoftuar për arsyet e arrestit të tyre, atyre u janë lexuar të drejtat, u është siguruar ushqimi, sipas nevojave u është ofruar kontrolli mjekësor dhe se të njëjtit janë liruar me kohë.

2.13. SIPK është bazë e të dhënave ku bëhet verifikimi, regjistrimi, evidentimi i të gjitha rasteve, të cilat lajmërohen në Polici. Palët që kanë nevojë për verifikim të të kaluarës kriminale, mund të parashtrajnë kërkesë në stacione/nënstacione policore më të afërta të vendbanimit, apo vendqëndrimin të parashtruesit të kërkesës, tanimë

edhe në platformën qeveritare e-Kosova. PSO - Verifikimi i të Kaluarës Kriminale parasheh se kërkesa kur parashtruesi, i të cilës nuk ka të kaluar kriminale, duhet realizuar brenda 24 orëve, për ditë pune (verifikimi, konfirmimi, plotësimi e lëshimi i vërtetimit). Stacioni për periudhën Janar-Shkurt (deri më 27.02.2023) ka pranuar 261 kërkesa nga palët për verifikim të të kaluarës kriminale, nga të cilat, 165 sosh janë adresuar direkt në Stacion, kurse 96 të tjera përmes platformës e-Kosova. Nga dhjetë (10) dosjet e kontrolluara në drejtim të vërtetimit lidhur me respektimin e PSO-së, është gjetur se tre (3) kërkesa për verifikim ishin në pritje më shumë se 24 orë për shkak se parashtruesit e tyre kanë pasur raste nëpër Gjykata dhe Prokurori. Vetëm në një (1) dosje është gjetur se ka pritje më shumë se 24 orë nga parashtrimi i kërkesës edhe pse parashtruesi nuk figuron të ketë të kaluar kriminale. IPK çmon punën e bërë nga Stacioni dhe inkurajon më tutje zyrtarët përgjegjës që në të gjitha rastet, të respektojnë afatet e parapara, për të eliminuar pritjet e palëve.

2.14. Planet operative janë mjet menaxhimi, që lehtësojnë koordinimin e burimeve të organizatës (njerëzore, financiare dhe teknike), në mënyrë që të jetë e mundur të arrihen qëllimet dhe objektivat. Në Polici janë disa nivele të përgatitjes së planeve, përfshirë atë qendror, rajonal dhe lokal. Në Stacion janë hasur plane operative të hartuar nga niveli lokal dhe ai qendror. IPK ka qenë e interesuar të njihet me planet që janë hartuar në nivel Stacioni dhe bazuar në këtë, janë kontrolluar katër (4) plane për vitet 2021/2022. Të gjeturat vejnë në pah se vetëm për njërin prej tyre (“Protestë e Sindikatës së re të KEK-ut”) ka raport pas operacional. Në raportet vjetore shihet se ndër veprat/incidentet më të shpeshta të evidentuara, janë kanosja, sulmi, lëndimi i lehtë trupor, vjedhja, vjedhja e rëndë, mbajtja në pronësi/kontroll ose posedim i pa autorizuar i armëve, aksidentet me dëm material dhe dhuna në familje. Megjithatë, vjedhja e rëndë dhe mbajtja në pronësi/kontroll ose posedimi i paautorizuar i armëve kanë qenë vepra në rritje përgjatë vitit 2022. Bazuar në të dhënat e pasqyruara në Raportin Vjetor është gjetur se në kuadër të Stacionit nuk janë hartuar kënaqshëm plane operative që adresojnë problemet për veprat/incidentet e shpeshta që ndodhin.

2.15. Fokus i inspektimit ka qenë edhe realizimi i planeve operative dhe njohja me planet operative që janë në zbatim. Në ditën e inspektimit, Stacioni ka qenë duke i realizuar nëntë (9) plane operative (“Kontrolli i shtuar i trafikut”, “Sezoni dimëror”, “Kulti”, “Qarkullimi i automjetit sipas vendimeve të fundit”, “Siguria në shkolla”, “Dorëza 2022”, “Parandalimi e njoftimi i degradimit dhe shkatërrimit të mjedisit”, “Ngritja e vigjilencës” dhe “Parandalimi i veprave penale”). Janë kontrolluar tre (3) dosje të fletë patrullimeve të zyrtarëve policor të ndërrimeve të ndryshme dhe nga aktiviteti i tyre është hasur se sipas ndarjes së detyrave figurojnë dhe plane operative që janë në zbatim. Të gjeturat tregojnë se zyrtarët policor kanë ndërmarrë aktivitete në drejtim të detyrave të planifikuara, por jo në të gjitha rastet gjatë ndërrimit janë adresuar çështjet e dala nga planet.

2.16. PSO - Procedimi i lëndëve dhe kompetenca lëndore e hetimit përcakton se kur patrulla del në vend ngjarje dhe në bazë të informatave vlerëson se nuk ka elemente të veprës penale, apo të kundërvajtjes, atëherë patrulla përpilon Shënim zyrtar për veprimet e ndërmarra lidhur me informatën dhe e dërgon në Operativën e Stacionit përmes zinxhirit komandues. Shënimi zyrtar me shkresa përcjellëse protokollohet dhe arkivohet në Operativë, ndërsa informatat në lidhje me këtë Shënim zyrtar përcillen tek njësia përkatëse (sektor policor, në Njësinë e Hetimeve, Inteligjencë e Stacionit, “nevoja për të ditur PUI”). Për të parë se sa respektohet PSO-ja, IPK ka kontrolluar pesë (5) lëndë me Shënime zyrtare, me fokus nëse kanë raporte fillestare të incidenteve, nëse janë evidentuar sipas rregullave (protokollimi, arkivimi), nëse janë trajtuar në mënyrën e duhur, nëse rastet që lidhen me pro-formën ndërlidhen me vepra penale, nëse është konsultuar Prokurori për rastet e tilla dhe nëse rastet janë përcjell te njësitë përkatëse. Asnjëra nga lëndët nuk ka qenë e protokolluar dhe nuk kanë pasur raport fillestar të incidentit. Në tre prej tyre nuk është hasur raporti i zyrtarit policor dhe njoftimi për Prokurorin mbi veprimet që janë ndërmarrë.

3. Parandalimi dhe luftimi i krimit

3.1. Neni 7 i Ligjit për Policinë përcakton se me qëllim të parandalimit e luftimit të krimit dhe për shtimin e sigurisë për të gjitha komunitetet në Republikën e Kosovës, Policia komunikon dhe bashkëpunon me autoritetet e qeverisë lokale, organizatat civile dhe komunitetet lokale. Strategjia për Policim në Bashkësi reflekton zotimin policor dhe përkushtimin në ngritjen e sigurisë në bashkësi me anë të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve me gjithë akterët, që mbulojnë fushën e sigurisë në bashkësi dhe që në mënyrë preventive veprojnë në identifikimin e zgjedhjen e problemeve, që shkaktojnë shqetësimin dhe frikën te qytetarët. Plani Veprues në kuadër të objektivave strategjike ka përcaktuar numër të konsideruar aktiviteteve, ku veç tjerash janë përfshirë edhe: organizimi i takimeve për siguri nëpër shkolla, organizimi i takimeve me forume të sigurisë/mediet/OJQ-të, organizatat e ndryshme me qëllim të promovimit të strategjisë në bashkësi, identifikimi i pikave të zeza dhe problemeve në trafik, etj. Informatat e pranuar përmes e-mailit edhe pse nuk mbështeten me raporte, procesverbale apo evidenca, pasqyrojnë se Stacioni:

- Në vitin 2021 ka realizuar tre (3) takime me forumet e sigurisë në KKSB dhe një (1) takim me KLSP, kurse në vitin 2022, gjashtë (6) takime me KKSB,
- Në vitin 2021 ka realizuar tre (3) vizita dhe ligjërata në shkolla, kurse në vitin 2022 ka realizuar dy (2) të tilla,
- Në vitin 2021 ka realizuar dy (2) takime me komunitetin kulturor dhe sportiv, kurse në vitin 2022 ka realizuar tre (3) të tilla.
- Në vitin 2022 ka realizuar një (1) takim për kushtet e trafikut dhe pikat e zeza,
- Në vitin 2022 ka realizuar një (1) inspektim të rrugëve,
- Ka realizuar nga një (1) projekt me komunitetin, për dy vitet ndarazi,
- Ligjërata mbi aktivitetet e dyshimta lidhur me EDhRT dhe takime me bizneset nuk janë realizuar.

3.2. Policimi i Udhëhequr nga Inteligjenca është model pune dhe filozofi drejtuese, ku produktet e inteligjencës gjejnë përdorim të gjerë në procesin e vendimmarrjes, e që ka për qëllim parandalimin e reduktimin e krimit dhe zgjedhjen e problemit, duke u fokusuar në eliminimin e e shkaktarëve, përmes menaxhimit strategjik dhe zbatimit efektiv të strategjive. Informata inteligjente është produkt që potencialisht parandalon apo zbulon krime të llojeve të ndryshme. Informatat analizohen dhe vlerësohen rreziqet. Informata inteligjente është informatë e thjeshtë, e cila kalon nëpër disa faza të vlerësimit dhe verifikimit, ku në përfundim nga kjo kemi produkt inteligjent, përmes të cilit parandalohet apo zgjidhet një problem. PUI nënkupton mbledhjen e informatave inteligjente për të vazhduar me parandalim dhe zgjidhje të problemeve, kështu që policimi në bashkësi do të ishte më efikas dhe efektiv. Stacioni në vitin 2021 ka dërguar përmes SIPK-ut, 183 raporte inteligjente 5x5x5x, qoftë përmes Zyrtarit për Inteligjencë dhe Analizë, qoftë përmes zyrtarëve policor. Kurse, në vitin 2022 janë dërguar 168 informata inteligjente. Nga matjet e kryera me 37 stacione, në vitin 2022 ka pasur ngritje të numrit të informatave inteligjente për 84%, krahasuar me një vit më parë. Nëse krahasojmë performancën e Stacionit në raport me mesataren e përgjithshme për 37 stacionet pasqyrohet se në vitin 2021 një (1) zyrtar policor ka dërguar mesatarisht tre (3) informata inteligjente, derisa mesatarja e përgjithshme është dy (2) informata. Në vitin 2022, një zyrtar policor ka dërguar mesatarisht tre (3) informata, derisa mesatarja e përgjithshme është katër (4) informata inteligjente.

3.3. Sipas nenit 10 të Ligjit për Policinë, ndër detyrat e përgjithshme të Policisë janë të parandaloj dhe zbuloj veprat penale dhe kryesit e tyre, si dhe të hetoj veprat penale dhe kryesit e tyre. Bazuar në këto autorizime, stacionet policore kanë detyra të ndara në parandalimin, hetimin e zbulimin e krimit. Nga analiza e suksesit për 37 stacione, pasqyrohet se ato gjatë vitit 2021 kanë pasur kuotë zbulueshmërie të veprave penale në lartësi prej 61.3%, derisa në vitin 2022 kjo kuotë është ngritur në 63.4%. Stacioni

	<p>i Obiliqit, kuotat e tilla i ka pasur në lartësi prej 61.3% për vitin 2021, përkatësisht 57.5% për vitin 2022. Nga këta indikatorë rezultojnë se në vitin 2021, zbulueshmëria e veprave penale nga Stacioni ka qenë në nivel të mesatares së përgjithshme të stacioneve, derisa në vitin 2022, ka pasur një rënie të zbulueshmërisë së rasteve në nivelin e mesatares së përgjithshme.</p> <p>3.4. Për të vlerësuar respektimin e rregullave dhe procedurave hetimore, IPK-ja ka kontrolluar kopjet fizike të pesë (5) mostrave të rasteve të dhunës në familje, që janë proceduar në Prokurori të Shtetit. Në kuadër të rasteve është vlerësuar rregullsia e lëndëve penale, nëse ato përmbajnë veprimet/dokumentet e formularët e nevojshëm lidhur me hetimin e dokumentimit të krimit. Është verifikuar respektimi i disa prej veprimeve paraprake hetimore, përdorimi i formularëve standard brenda rasteve, si dhe regjistrimi i tyre sipas procedurës së regjistrimit të rasteve në regjistrat përkatës:</p> <p>(a) Konform nenit 81 të KPP-së, Stacioni ka ngritur kallëzime penale kundër të dyshuarve për veprën penale “Dhunë në familje”. Të dhënat mbi rastet e marra si mostër janë regjistruar në SIPK. Kallëzimet janë dorëzuar në Prokurori së bashku me procesverbalet, raportet dhe format bazike të të dhënave të rasteve. Kallëzimet janë nënshkruar edhe nga Komandanti i Stacionit, në kundërshtim me PSO - Procedimi i lëndëve dhe kompetencat lëndore të hetimit. Sipas PSO-së, kallëzimet para procedimit nënshkruhen nga hetuesi, mbikëqyrësi i vijës së parë në Sektorin e Hetimeve (rreshteri) dhe përmes tij, nga Shefi i Hetimeve. Lëndët janë proceduar në Prokurori përmes SMIL⁵ dhe në formë fizike. Është verifikuar procedimi i lëndëve përmes SMIL dhe veprimi i tillë dokumentohet, mirëpo janë evidentuar mangësi në futjen e dokumenteve, ku në dy raste nuk janë përfshirë urdhrat mbrojtës si dokumente plotësuese të lëndëve⁶. Është matur koha mesatare e procedimit të kallëzimeve në Prokurori dhe nga mostrat del se rastet janë proceduar mesatarisht për 26.6 ditë (2 prej tyre brenda 24 orëve, 1 pas 23 dite, 1 pas 52 ditëve dhe 1 pas 56 dite nga koha e raportimit). Në katër (4) nga pesë (5) mostrat dëshmohej që në proces për trajtimin e viktimave janë përfshirë zyrtarë të QPS, ndërsa nuk janë gjetur të dhëna mbi pjesëmarrjen e Mbrojtësit të viktimave⁷. Bazuar në raportet e policit, hetuesit përmes e-mailit kanë njoftuar Mbrojtësin e viktimave lidhur me rastet, por njoftimi nuk gjendet i bashkëngjitur në dosje. Viktimave u është ofruar trajtim mjekësor dhe mbi ekzaminimet janë nxjerrë raporte mjekësore.</p> <p>(b) Sipas procedurave në fuqi, në fazën e veprimeve fillestare, Policia vlerëson rrezikun për viktimën e dhunës në familje në praninë edhe të Mbrojtësit të viktimave. Lidhur me këtë, si pjesë e vlerësimit të rrezikut, Policia duhet të përgatisë formën bazike të të dhënave për rastin⁸. Në tre raste nuk është bërë vlerësimi mbi shkallën e rrezikut, kurse në dy raste është bërë vlerësimi bazuar në indikatorë përkatës sipas formës standarde të paraparë me PSO.</p> <p>(c) Pakoja informuese për viktimat e krimit, që përmban kartelën e viktimës me informata dhe këshilla mbi rastin, është obligative që nga viti 2020, që të jetë pjesë e rastit dhe dosjes. Në dosjet e kontrolluara është gjetur që në katër raste, viktimat janë pajisur me Pakon, kurse në një rast nuk është gjetur një e tillë.</p>
--	---

⁵ Kur përfundon hetimi, hetuesi duhet të dërgoj lëndën për nënshkrim tek Mbikëqyrësi i vijës së parë në Sektorin e Hetimeve dhe përmes tij tek Shefi i Hetimeve. Më tutje, PSO përcakton se pas procedurave të lartcekura, hetuesi lëndën e regjistron në modulën për Sistemin SMIL dhe e përcjellë në Prokurorinë e Shtetit.

⁶ 2022-AJ-0292 dhe 2022-AJ-400.

⁷ Sipas Ligjit Nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Mbrojtësi i viktimave është personi i autorizuar zyrtar, i cili ndihmon drejtpërdrejtë palën e dëmtuar që nga kontaktet e para me organet kompetente të mbrojtjes, këshillon, inicion procedurat për caktimin e masave të mbrojtjes, është i obliguar të marr pjesë në të gjitha seancat gjyqësore, të monitorojë mbarëvajtjen e procesit gjyqësor.

⁸ Kapitulli 5.2 i Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë, faqe 33.

	<p>(d) Gjatë përzgjedhjes së mostrave, janë shënjestruar raste⁹ ku ndaj viktimave janë aplikuar urdhra mbrojtës. Kur ka qenë e nevojshme ndërmarrja e veprimeve me qëllim të zbatimit të tyre, Policia ka bashkëpunuar ngushtë duke iu ofruar ndihmën e nevojshme viktimave me qëllim të ofrimit të sigurisë. Në lëndët me numër 2022-AJ-0400, 2022-AJ-0406 dhe 2021-AJ-0238 gjenden evidenca për ekzekutimin e masave për mbrojtje nga dhuna në familje, që tregojnë kontakte e vizita që Policia u ka bërë viktimave. Në rastet kur mosrespektimi i urdhrat është bërë nga viktimat, Policia ka intervistuar palët, ka kontaktuar kohë pas kohe me ta, për të pasur nën mbikëqyrje rastet.</p> <p>(e) Në kuadër të kriterëve për kontrollimin e dosjeve është vlerësuar prezenca e Raportit policor brenda dosjes hetimore, që i drejtohet Prokurorit kompetent për njoftim mbi dyshimin e arsyeshëm se është kryer vepra penale¹⁰. Në dy (2) prej dosjeve është gjetur që kallëzimet penale bashkë me raporte policore janë proceduar tek Prokurori brenda 24 orëve, ndërsa në tre (3) raste tjera nuk është gjetur njoftim me shkrim brenda këtij afati.</p> <p>(f) Policia ka të hartuar formularët e nevojshëm të punës, të harmonizuar me aktet ligjore në fuqi dhe të njëjtë iu shërbejnë zyrtarëve policorë gjatë kryerjes së veprimeve hetimore. Formularët e përdorur brenda dosjeve hetimore janë unik në kuadër të Stacionit dhe ka një standard të caktuar të hartimit të tyre.</p> <p>(g) Policia luan rol me rëndësi në mbrojtjen dhe respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut¹¹. IPK ka vlerësuar respektimin e të drejtave në procedurë paraprake, gjatë marrjes në pyetje të të dyshuarve e dëshmitarëve. Deklaratat përmbajnë të drejtat e personave të intervistuar dhe janë të nënshkruar nga ta.</p> <p>(h) Është e nevojshme të ushtrohet kontroll mbi hetuesit me qëllim të rritjes së kualitetit dhe profesionalizmit në trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Është e nevojshme që gjatë intervistimit të palëve të parashtrajnë numër më të madh të pyetjeve lidhur me rastin dhe që në konsultim me Prokurorin kompetent, të përfshijnë dhe dëshmitarë të tjerë potencial që mund t'i kontribuojnë zbardhjes së rastit. Gjatë hartimit të kallëzimit penal, nevojitet të ngritet performanca në vendosjen e saktë të të dhënave të mbledhura përmes veprimeve hetimore, të tregohet ndaj kujt ngritet kallëzimi, evidenca për të dëmtuarit apo viktimat, dhe të arsyetohet saktë ngritja e kallëzimit mbështetur në faktet e grumbulluara përmes veprimeve hetimore.</p> <p>(i) Punonjës në Sektorin e Hetimeve kanë shprehur sfidat e tyre gjatë zhvillimit të procesit të punës dhe procesit hetimor në tërësi. Brenda Sektorit të Hetimeve janë shprehur pakënaqësi në vonesat e paarsyeshme të procedimit të rasteve në Prokurori pas marrjes së veprimit të fundit hetimor nga hetuesit. Këto lëndë nuk kanë të bëjnë me vepra penale kundër martesës e familjes, por janë ofruar si informata gjatë ekzaminimit të dosjeve që lidhen me rastet e dhunës në familje. Janë siguruar dy lëndë¹², që në Prokurori nuk janë proceduar me kohë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lënda nr. 2021-AJ-0395 me dyshimin për kryerjen e veprës penale “Sulm” (neni 184) dhe “Asgjësim dhe dëmtim i pasurisë” (neni 321 i KPRK) është proceduar në Prokurorinë e Shtetit me kallëzim penal. Veprimi i fundit i hetuesit në këtë rast është i datës 23.02.2022. Kallëzimi është aprovuar nga mbikëqyrësit më 14.05.2022, ndërsa bashkë me veprimet e tjera hetimore është proceduar në Prokurori Themelore, 11 muaj pas veprimit të fundit
--	--

⁹ 2021-AJ-0441, 2022-AJ-400, 2021-AJ-0238, 2022-AJ-0406 dhe 2022-AJ-0292.

¹⁰ Sipas nenit 70, paragrafi 5 të KPP-së, posa Policia të ketë dyshim të arsyeshëm se është kryer një veprë penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare, është e detyruar që brenda 24 orëve t'i dorëzojë një raport policor Prokurorit të Shtetit që është kompetent, i cili pastaj vendos nëse duhet filluar procedurë penale.

¹¹ Bazuar në nenin 122 të KPP-së, në fillim të marrjes në pyetje në procedurë paraprake, hetuesi i autorizuar nga Prokurori i Shtetit, para marrjes në pyetje i lexon dëshmitarit apo të dyshuarit paralajmërimet mbi të drejtat e rezervuara me Ligj dhe i njëjti duhet të konfirmoj me shkrim mbi të kuptuarit e të drejtave të lexuara nga hetuesi.

¹² 2018-AJ-376 dhe 2021-AJ-0395.

	<p>hetimor, apo 8 muaj pas aprovimit të kallëzimit penal (20.01.2023). Gjatë analizës së veprimeve hetimore është gjetur se menjëherë pas raportimit të rastit nga ankuesi (i dëmtuari), hetuesi përgjegjës më 13.11.2021 ka njoftuar me shkrim Prokurorin kompetent, njoftimi për të cilin nuk ka përmbajtur informata të plota mbi rrethanat se si ka ndodhë rasti, që janë kallëzuar nga viktima, të shënuara në Procesverbalin e marrjes në pyetje të të dëmtuarit¹³. Hetuesi në njoftimin me shkrim për Prokurorinë, në ditën që ka ndodhë rasti, nuk ka paraqitur sulmin fizik të ndodhur, të raportuar nga viktima. Po ashtu, janë hasur mangësi edhe në përshkrimin e dispozitivit dhe arsytimit të kallëzimit penal. Edhe pse hetuesi ka qenë i njohur me përmbajtjen e video incizimit lidhur me rastin, ai nuk ka përshkruar sa duhet veprimet dhe personat e përfshirë në të. Përshkrimi i saktë i veprimeve bazuar në video incizim, do të sqaronte përfshirjen ose jo, të të gjithë personave në kallëzim penal, për të cilët ka pasur raportim nga viktima.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në rastin 2018-AJ-376 me dyshimin për kryerje të veprës penale “Sulm”, i ndodhur me datën 15.11.2018, veprimi i fundit hetimor është ndërmarrë më 08.12.2019, ndërsa kallëzimi është proceduar në Prokurori më 11.03.2021. Në rastin e proceduar me kallëzim penal si pjesë e dosjes janë përfshirë dokumentet mbi veprimet hetimore në ndriçimin e tij (procesverbalet e marrjes në pyetje të viktimës dhe të të dyshuarit). Mos procedimi me kohë i lëndëve në Prokurori mund të sjellë deri te parashkrimi i tyre e që në këto raste tregon mos përmbushje të detyrës nga Policia dhe mosveprimi pengon zhvillimin efektiv të procesit hetimor. <p>3.5. Sa i përket interesimit të IPK-së lidhur me kushtet fizike e të sigurisë në Dhomën e Dëshmive, inspektorët kanë vërejtur se ajo është e vendosur në katin e përdhese brenda objektit të Stacionit. Dera e saj është e punuar nga druri, ndërsa për të shtuar sigurinë mbi të, është vendosur derë nga konstruksioni metalik. Dhoma ka dritare, të konstruara për të pamundësuar qasjen përmes tyre. Dhoma nuk është e pajisur me aparat për fikje zjarri, alarm kundër hyrjes së paautorizuar, ndërsa ka të instaluar detektorët e tymit (nuk janë kryer teste për të ditur nëse i njëjti është funksional). Sistemi i ventilimit është funksional, ndërsa sistem të kondicionimit dhe të ngrohjes nuk ka të instaluar. Dhoma u siguron qasje të kufizuar personave që e vizitojnë atë. Çdo hyrje e personelit tjetër regjistrohet në Regjistër të qasjes në këtë Dhomë. Kjo Dhomë është e monitoruar me kamera të sigurisë.</p> <p>3.6. Sipas rregullit, çdo lëvizje e sendit a dëshmisë duhet të regjistrohet në Regjistër dhe data bazë, dhe për të njëjtën duhet bashkëngjitur kopja e raportit të ekzaminimit, e cila duhet të ruhet në dosjet e Dhomës së dëshmive¹⁴. Në tre (3) raste nuk janë evidentuar lëvizjet e dëshmisë në mënyrën e duhur për secilën dëshmi të kërkuar. Dëshmitë e deponuara në tre (3) nga pesë (5) rastet e inspektuara nuk kanë pasur të bashkëngjitur zinxhirin e ruajtjes, kurse të dhënat për dëshmitë e deponuara kanë qenë të plotësuara në librin fizik dhe data bazë elektronike. Numri i dëshmive fizike (artikujve) me informatat në Regjistrin e dëshmive¹⁵ e Zinxhirin e ruajtjes për pesë (5) nga dëshmitë e inspektuara ka qenë në përputhje. Zyra e pranimit të dëshmive</p>
--	---

¹³ Procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtuarin i datës 13.11.2021.

¹⁴ PSO - Dhomat e dëshmive në pikën E, paragrafi 17 dhe 18 rregullon që çdo lëvizje e sendit apo dëshmisë, të dorëzuar në gjykatë apo njësi tjetër, që i është kthyer pronarit apo personit të autorizuar, regjistrohet në Regjistër dhe në bazën e të dhënave. Në rast se sendi dhe dëshmia është dorëzuar për ekzaminim/analiza në laboratorin kriminalistik, kjo lëvizje regjistrohet në Regjistër të dëshmive dhe data bazë. Në rast kur dëshmitë me urdhëresë kërkohen nga Gjykata - Prokuroria, dorëzohen për ekzaminim/analiza apo ri-ekzaminim në laborator, kjo regjistrohet në Regjistër dhe data bazë, dhe për të njëjtën duhet të bashkëngjitet kopja e raportit të ekzaminimit, e cila duhet të ruhet në dosjet e dhomës së dëshmive.

¹⁵ PSO - Dhomat e dëshmive, pika G, paragrafi 3 përkufizon se “regjistri i dëshmive është një regjistër (formular apo libër) për regjistrimin e të gjitha dëshmive të konfiskuara apo provave të gjetura, të vjedhura etj. Të gjitha dëshmitë të cilat gjenden të deponuara në dhomë duhet të regjistrohen në regjistër të dëshmive.

	<p>nuk gjendet në afërsi të Dhomës së dëshmimeve, dëshmitë pranohen një kat më lartë brenda objektit, në zyrën e Zyrtarit përgjegjës për Dhomën e dëshmimeve. Në Dhomën e dëshmimeve mbahen armë që më parë ishin me leje të lëshuar nga organi kompetent, por që tani iu ka skaduar ky afat dhe për shkaqe sigurie të njëjtat ruhen brenda Dhomës. Originali i formës së zinxhirit të ruajtjes duhet të mbetet në Dhomë të dëshmimeve së bashku me sendin/dëshminë, ndërsa kopja, në dosjen e dëshmisë¹⁶. Gjatë inspektimit janë gjetur parregullsi në administrimin e dokumenteve që lidhen me dëshmitë. Nuk janë prezantuar dokumente kopje të ruajtura në një vend të dytë, andaj në tre (3) nga pesë (5) rastet e inspektuara, zinxhirët e ruajtjes dhe dokumente tjera që lidhen me dëshmitë janë siguruar nga dosjet penale në Sektorin e Hetimeve.</p> <p>3.7. IPK ka vlerësuar mënyrën e ruajtjes dhe evidentimit të sendeve të sekuestruara. Vlerësohet se gjetjet nuk kanë rezultuar në tërësi pozitive e në harmoni me kriteret e ruajtjes dhe evidentimit të sendeve. Vendosja dhe paketimi i dëshmimeve nuk është bërë në të gjitha rastet varësisht prej specifikave të tyre. Është gjetur që dëshmitë biologjike nuk ruhen në vende të posaçme dhe në temperatura adekuate (brenda dhomës nuk ka frigorifer). Armët e zjarrit nuk janë të deponuara në dhomë të ndarë, apo arkë metalike brenda zonës deponuese, kurse bankënotat e gjërat e çmuara deponohen në sef të ndarë brenda zonës së deponimit. Hapësira brenda Dhomës nuk plotëson nevojat e Stacionit për të deponuar dëshmitë, andaj dëshmitë janë vendosur edhe në dysheme. Zyrtari përgjegjës i kësaj Dhome pjesërisht mbanë evidencë për sistemin e numrit, emërtimin e raftit dhe udhëzimin se ku gjenden dëshmitë a sendet e deponuara. Zyrtari përgjegjës ka qenë i gatshëm për të identifikuar dëshmitë, por jo në kohë të shkurtër.</p> <p>3.8. Me qëllim të ushtrimit të kontrollit adekuat, duke bërë rishikim formal periodik dhe verifikues për të vërtetuar korrektësinë e rrjedhën e punës, verifikim të pranisë së sendeve e dëshmimeve të mbajtura në Dhomë të dëshmimeve në krahasim me regjistrat, dhe të vlerësohet rrjedha e punës duke shikuar përmbushjen e procedurave, aspektin e sigurtisë e kushtet e punës së zyrtarëve policor, organi kompetent duhet të realizojë revizion, inventarizim dhe inspektim në Dhomën e dëshmimeve. Për vitin 2021 nuk është prezantuar asnjë raport i kontrollit në këtë Dhomë, derisa një inspektim është realizuar në vitin 2022. Mungesa e kontrolleve efektive vjen nga neglizhenca për të ushtruar kontrollin e nevojshëm mbi Dhomën e dëshmimeve dhe dëshmitë.</p> <p>4. Kushtet teknike të punës dhe të sigurtisë</p> <p>4.1. Stacioni ka gjithsej tetë (8) automjete dhe të gjitha në gjendje funksionale. Nga një inspektim i realizuar në vitin 2022, IPK ka kryer analiza, të cilat kanë pasqyruar se një (1) automjet zyrtar mesatarisht ka qenë në dispozicion të nëntë (9) punonjësve policor. Sipas matjeve të kryera në Stacion, një (1) automjet është në dispozicion të mesatarisht tetë (8) punonjësve. Sa i përket vjetërsisë mesatare, del se automjetet e këtij Stacioni kanë afërsisht 11 vjet jetëgjatësi, moshë kjo identike me moshën e përgjithshme të Flotës së Policisë. Kurse, sa i përket amortizimit teknik, automjetet e këtij Stacioni kanë të kaluara mesatarisht 178.342 kilometra, që paraqet shkallë më të ulët të amortizimit, krahasuar me Flotën policore, automjetet e së cilës sipas matjeve të vitit të kaluar kanë pasur mesatarisht nga 217.640 kilometra të kaluara.</p> <p>4.2. Udhëzimi Administrativ nr. 03/2008 për Përdorimin e Automjeteve të Qeverisë së Kosovës në nenin 6 dhe 7 ka përcaktuar detyrat e përgjegjësitetë në kontrollimin e automjeteve para përdorimit. Edhe Doracaku i Parimeve e Procedurave, në Parimin P-10.01 lidhur me shfrytëzimin e automjeteve, ka përcaktuar përgjegjësitetë e detyrat e mbikëqyrësve/përdoruesve të automjeteve në mirëmbajtjen ditore sipas formularit</p>
--	---

¹⁶ PSO - Dhomat e dëshmimeve, pika G, paragrafi 2 përkufizon se “zinxhiri i ruajtjes së sendit, pasurisë, provës apo parasë së gjetur është dokument apo formular i domosdoshëm që evidenton - prezanton konfiskimin, pranim-dorëzimin, ekzaminimin, lëvizjet, vendosjen dhe ruajtjen e sendeve dhe dëshmimeve, si dhe prezencën apo qasjen e zyrtarëve policor”.

të listës së verifikimit të automjetit. Nga inspektimi i automjeteve rezulton se para përdorimit, zyrtarët policor kryejnë kontroll vizual të tyre dhe verifikojnë prezencën e pajisjeve brenda automjeteve sipas formularit standard të kontrollit të pajisjeve. Po ashtu edhe Zyrtari i ngarkuar me mbikëqyrjen e automjeteve realizon inspektime të rregullta dhe një i tillë ishte realizuar së fundmi më 23.02.2023.

4.3. Sipas nenit 39 të Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete përcakton se në mënyrë që të marrin pjesë në trafik rrugor, mjetet duhet të jenë të regjistruara dhe të posedojnë certifikatë të regjistrimit të mjetit valide ose leje valide për ngasje provuese, të jetë i shënuar me targë regjistrimi ose targa provuese të vendosura për identifikim të mjetit. Kontrollimi i certifikatave të regjistrimit dhe policave të sigurimit vë në pah se të gjitha automjetet janë të siguruara/regjistruara me kohë dhe nuk ka ndodhur që të ketë vonesa në regjistrimin me kohë të tyre.


4.4. Udhëzimi Administrativ nr. 02/2008 për Përdorimin e Automjeteve të Qeverisë së Kosovës obligon çdo drejtues të automjetit zyrtar që në Fletë udhëtim të shënojë numrin e kilometrave të automjetit në momentin e nisjes, destinacionin e udhëtimit, qëllimin e udhëtimit, numrin e kilometrave të kaluara në momentin e kthimit dhe nënshkrimin e përdoruesit. Sa përket kësaj fushe, Udhëzimi respektohet plotësisht pasi fletë udhëtimet plotësohen rregullisht dhe përmbajnë të dhënat e nevojshme.

4.5. PSO për Flotën Operative përcakton që “mbikëqyrësi i secilës njësi që posedon automjete, duhet të sigurohet që ato të pastrohen në mënyrë periodike, jashtë dhe brenda, që t’i mirëmbahet pamja”. Gjatë kontrollit është parë se kjo pikë zbatohet plotësisht, meqë automjetet janë hasur të pastra, si brenda ashtu dhe jashtë.

4.6. Bazuar në nenin 207 të Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, automjeti i udhëtarëve, kamioni dhe autobusi gjatë qarkullimit të tyre në trafikun rrugor duhet t’i posedojnë pajisjet rezervë dhe shtesë, si: poçet rezervë, kutinë e ndihmës së parë, trekëndëshin e sigurisë, pajisjen për tërheqje të mjetit në defekt, jelekun reflektues, ndërsa aparatën për fikje të zjarrit në rastet kur përdorimi i tij parashihet me ligj. Pajisjet duhet të jenë të kompletuara dhe me afat përdorimi. Sipas nenit 203 të Ligjit, shoferi gjatë drejtimit të mjetit duhet t’i mbajë me vete mes tjerash edhe certifikatën e regjistrimit të automjetit, policën e sigurimit dhe raportin evropian të aksidentit. Sipas nenit 26 të Udhëzimit Administrativ (MI) nr. 01/2018 për Kontrollimin teknik të automjeteve, kontrollimi i pajisjeve rezervë dhe shtesë të automjetit përfshinë: çelësin e rrotave, ngritësen mekanike ose hidraulike, gomën rezervë, aparatën e fikjes së zjarrit, trekëndëshin, ndihmën e parë, dritat rezervë, pajisjet e dimrit-zinxhirët. Bazuar në formularët e kontrollit të pajisjeve që përbëhet nga një Listë prej 30 pajisjesh, automjeteve mesatarisht u mungon 1/3 e tyre. IPK ka pasur fokus te Lista e pajisjeve që parashihet me legjislacionin e lartshënuar dhe inspektimi ka nxjerrë se:

- Edhe pse gjashtë (6) automjete të inspektuara kanë aparatet për fikje të zjarrit, vetëm njëri prej tyre ka qenë me afat të përdorimit,
- Tre (3) nga gjashtë (6) automjetet nuk kanë drita rezervë,
- Katër (4) nga gjashtë (6) automjetet nuk kanë jelek reflektues,
- Pesë (5) nga gjashtë (6) automjetet nuk kanë Raportin evropian të aksidentit.

4.7. Inspektorët kanë verifikuar masat e sigurisë brenda e jashtë Stacionit. Është me rëndësi marrja e masave të nevojshme të sigurisë për të siguruar burimet, objektin, pronën dhe palët. Stacioni është nën monitorim me sistem kamerash 24/7, rrezja e të cilit mbulon perimetrin e jashtëm e të brendshëm të Stacionit. Sistemi mbikëqyret nga një dhomë e veçantë përmes monitorit, kurse administrohet nga DTIK. Para hyrjes në Stacion angazhohet Polici statik, që komunikon me palët, kryen kontrollet me magnetometër dhe evidenton hyrje - daljet. Aparatet për fikjen e zjarrit janë të vendosur në pikat kyçe të objektit, por janë me afat të skaduar. Stacioni është i pajisur me Planin e Reagimit Emergjent, Planin e Hartimit të Politikave të Sigurisë - Evakuimit dhe Planin e Reagimit Emergjent në Raste të Fatkeqësive. Stacioni ka

	<p>të lokalizuar vendin për zbrazje të sigurt të armës afër hyrjes kryesore. Higjiena brenda dhe jashtë Stacionit është e nivelit të dëshiruar.</p> <p>4.8. Për të konstatuar aspektet e sigurisë brenda Qendrës së Ndalimit janë vlerësuar komponentët me rëndësi që shpijnë në ngritjen e nivelit të sigurisë. Brenda Qendrës është instaluar sistemi i monitorimit, që përdoret për të monitoruar të ndaluarit. Neni 76 i Ligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale përcakton që personat në sektorin publik mund t'i instalojnë sistemin e vëzhgimit me kamera për vëzhgim të objektit nëse konsiderohet e nevojshme për sigurinë e njerëzve dhe pasurisë. Në ditën e inspektimit, ky sistem ka funksionuar. Konform PSO-së, Qendra e Ndalimit ka ndriçim të mjaftueshëm natyral e artificial, ajrim të mjaftueshëm dhe pa lagështi. Higjiena brenda Qendrës së Ndalimit është në nivel të padëshiruar.</p> <p>4.9. Mjetet e punës janë faktorë me rëndësi për punë profesionale dhe të suksesshme. Stacioni ka pasqyruar se ka këtë gjendje me pajisje të punës:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fotokopje funksionale - 2 copë (njëra pronë policore, tjetra e kontraktuar), - Printer funksional - 9 copë, - Kompjuter funksional - 24 copë (të vjetërsuar), - Llap top funksional - 3 copë, - Pajisje funksionale për matje të shpejtësisë së lëvizjes së mjeteve - 1 copë, - Alkooteste - 3 copë (nga të cilët, 2 janë funksional dhe 1 jashtë përdorimi). <p>4.10. Rregullorja (MF) nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore në nenin 18 përcakton që inventarizimi bëhet me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo financiare. Kjo Rregullore përcakton tutje se organizatat buxhetore duhet të kontrollojnë së paku njëherë në vit pasurinë jo financiare për të vërtetuar dhe vlerësuar gjendjen faktike të pasurisë jo financiare. Procesin e inventarizimit e ka udhëhequr niveli qendror, por nuk ka ndonjë raport kthyes mbi inventarizimin.</p> <p>4.11. Rregullorja në fjalë përcakton që të gjitha organizatat buxhetore obligohen që të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, ruajtjen, evidentimin, tjetërsimin dhe raportimin e pasurisë jo financiare me qëllim të menaxhimit më efektiv, efikas dhe ekonomik, me qëllim të mbrojtjes së pasurisë jo financiare nga dëmtimi dhe keqpërdorimi. IPK-ja ka verifikuar prezencën fizike në raport me Listën e pajisjeve - inventarit në pesë (5) zyra të Stacionit (nr. 20, 22, 24, 27, 28). Zyrat kanë ekspozuar Listat e pasurive në vende të dukshme dhe të dhënat brenda tyre mbështeten nga prezenca e pajisjeve dhe inventarit brenda zyrave.</p>
<p>Vlerësimi i përgjithshëm (përfundime)</p> 	<p>Bazuar në gjetjet e inspektimit, IPK-ja vlerëson se:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✚ Stacioni ka dobësi sa i përket funksionalizimit të disa njësive policore, sistemimit të personelit, përmbushjes së Strukturës, tejkalimit të numrit të vendeve të punës dhe sistemimit në kundërshtim me vendimet dhe përkrahjet e vendeve të punës. Stacioni nuk e mbanë të plotë Regjistrin e vijueshmërisë, meqë brenda tij janë përfshirë vetëm punonjësit që vijnë orarin e rregullt të punës 08.00-16.00. Të dhënat e Regjistrit të vijueshmërisë përputhen me gjendjen dhe prezencën fizike të personelit. Ka vërejtje sa i përket mbajtjes së pajisjeve, pasi jo të gjithë zyrtarët policorë i mbajnë komplet pajisjet. Në kuadër të Stacionit respektohet standardi e uniformës dhe dukjes personale. Inspektimet lidhur me mirëmbajtjen e pajisjeve janë të pamjaftueshme, si dhe ka mungesë raportesh të kontroleve. Armëve dhe municionit u është kushtuar kujdes sa i përket mirëmbajtjes, derisa spreji e jeleku anti - plumb janë pa afat. Ka një mungesë të evidencave të sakta mbi trajnimet e brendshme dhe ricertifikimin. Shkeljet e lehta disiplinore në nivel Stacioni nuk janë trajtuar brenda afateve. Vlerësimi i performancës në punë është kryer në të gjitha rastet (mostrat), brenda afateve dhe sipas formularit standard.

- ✚ Logu nuk azhurnohet sa duhet me të dhëna dhe nuk dokumentohet se ushtrohen auditime të planifikuara. Stacioni ka kohë të kënaqshme mesatare të reagimit në thirrjet e qytetarëve, që është në nivel të mesatares së përgjithshme të stacioneve. Ka reduktim të rasteve kur reagimet në thirrje kanë qenë më të shtyra. Varësisht prej niveleve drejtuese dhe operative, Stacioni kryen raportimet e nevojshme mbi aktivitetet policore. Rastet me raport fillestar të incidentit ndjekin rregullat mbi procedimin e tyre. Patrullat janë hasur duke patrulluar sipas Orarit me përbërje ekipesh sipas Planit. Vitin e fundit është shënuar ngritje e aktivitetit patrullues. Stacioni ka praktikuar më tepër patrullime në këmbë, derisa ato me automjet janë më pak evidente. Kërkohej një analizë mbi patrullimet e pakta me automjet dhe rënien e numrit të gjobave, për t'u siguruar se ushtrohet kontroll efikas i trafikut. Kundërvajtjet regjistrohen në SIPK, po ka dobësi në mbajtjen e evidencës fizike. Shkalla e lartë e ekzekutimit të urdhëresave përcillet me performancë pozitive edhe sa i përket kuotës së urdhëresave të parashkuara dhe të mbetura. Numri i veprimeve në realizimin e urdhëresave që janë parashkruar ka qenë i pa mjaftuar dhe deri në ndërmarrjen e veprimit të parë ka një periudhë të gjatë mosveprimi. Pas skadimit të afatit prej 365 ditë të urdhër arresteve, apo të revokimit të tyre, ato shlyhen me kohë nga SIPK. Asnjëra dosje për përdorim të forcës nuk ka të bashkangjitur vendime të KSHPF. Dosjet e personave të ndaluar janë në harmoni me ligjin dhe ndaj tyre janë respektuar të drejtat e përcaktuara me ligj. Stacioni është azhur në verifikimin e kërkesave të palëve që aplikojnë për të kaluarën kriminale. Edhe pse përpilohen plane, ka mungesë të atyre që ndërlihen me dukuritë apo disa vepra që pasqyrohen në raporte vjetore. Lidhur me realizimin e planeve, ka mungesë raportesh pas operacionale. Aktivitetet e ndërmarra në realizimin e planeve deri diku janë të kënaqshme, ku shtrohet nevoja për t'u marrë parasysh më shumë në të ardhmen. Rastet e mbetura si Shënim zyrtar nuk janë kompletuar konform standardit.
- ✚ Me gjithë punën në zbatim të Strategjisë për Policimin në Bashkësi, ka mungesë procesverbalesh dhe raportesh të aktiviteteve. Me gjithë shtimin e informatave inteligjente në vitin 2021, performanca pozitive ka pësuar një rënie në vitin 2022 dhe nuk përcjellë trendin në rritje të pjesës më të madhe të stacioneve. Kuota e zbulimit të veprave penale në vitin 2022 nuk përcjellë trendin e përgjithshëm të stacioneve policore. Raportimi i dyshimit të arsyeshëm lidhur me veprën penale praktikohet si raportim verbal nga hetuesit për Prokurorin dhe kjo është mënyrë jo e duhur, ngase lë hapësirë për devijim informatash apo interpretimi jo të drejtë të rrethanave të rastit. Ka një shmangie në procedimin e kallëzimeve penale në Prokurori në raport me PSO-në, që ka rritur rrezikun për vonesa në procedimin e lëndëve (fokusi këtu vihet te qasja aktuale për nënshkrim të lëndëve edhe nga Komandanti). Në drejtim të ngritjes së efektivitetit e profesionalizmit, tek rastet e dhunës në familje duhet kushtuar vëmendje, sigurimit të më shumë informatave gjatë trajtimit të rasteve. Vlerësimi i rrezikut bazuar në indikatorë përkatës jo në gjithë rastet është kryer sipas rregullit. Viktimat iu kanë nënshtruar ekzaminimit mjekësor. Vihet në pah nevoja për marrjen parasysh edhe të dëshmitarëve tjerë potencial, rritjen e cilësisë së kallëzimeve dhe që gjatë evidentimit të dosjeve në SMIL, të përfshihen dhe urdhrat mbrojtës. Procedimi i lëndëve në Prokurori nuk është bërë në kohë optimale dhe ka vonesa të theksuara nga marrja e veprimit të fundit hetimor nga ana e Policisë (ka vonesa në procedim të lëndëve edhe pas aprovimit të tyre). Kjo mund të sjellë deri te parashkrimi i tyre e që në këto raste tregon mos përmbushje të detyrës nga Policia dhe mosveprimi pengon zhvillimin efektiv të procesit hetimor. Ka evidenca mbi mbikëqyrjen e urdhrave mbrojtës. Formularët në kuadër të dosjeve janë unik. Janë evidentuar parregullsi në trajtim të dëshmive dhe në evidencat lidhur me to. Kushtet teknike e të sigurisë brenda Dhomës së dëshmive duhet avancuar tutje. Format e kontrollit dhe mbikëqyrjes nga menaxhmenti në Dhomën e dëshmive janë të rralla, apo nuk zhvillohen fare.

	<p>✚ Stacioni ka një park funksional të automjeteve që plotëson nevojat, me parametra teknik më të mirë se përgjithësisht Flota e Policisë (jetëgjatësia dhe amortizimi). Automjetet mirëmbahen dhe kontrollohen para përdorimit. Të gjitha automjetet janë regjistruar me kohë. Fletë udhëtimet azhurnohen me kohë me të dhënat e nevojshme. Automjetet policore janë hasur të pastra. Atyre u mungojnë disa nga pajisjet, kurse pajisjet për fikje të zjarrit janë me afat të skaduar. Masat e sigurisë në Stacion janë të kënaqshme, në përjashtim të aparateve për fikjen e zjarrit që u ka skaduar afati përdorues. Kushtet e ndriçimit e ajrimit janë sipas standardeve. Shqetësues mbetet pastërtia jo në nivel brenda Qendrës së Ndalimit, si rezultat i mungesës së shërbimit të pastrimit. Nuk ka pasur vërejtje sa i përket pajisjeve të zyrës apo për punë terreni. Inventarizimi i pasurive është kryer, listat e pasurive janë hasur në zyra dhe të dhënat e tyre përputhen me prezencën fizike të pasurive.</p>
--	--

Përmbledhja e rekomandimeve dhe Plani i Veprimit				
Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore	Plani i veprimit
1.	IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit që në koordinim me Drejtorin Rajonal dhe Drejtorin e Personelit, të ndërmarrin veprime në adresimin e çështjeve që lidhen me funksionalizimin e plotë të Strukturës dhe sistemit të personelit.	-II-	Sipas Strukturës së re Organizative, do punohet në drejtim të sistemit të personelit.	K4 2023
2.	IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit që të veproj për të siguruar se në kuadër të Stacionit mbahet Regjistër i plotë i vijueshmërisë për gjithë të punësuarit.	-II-	Në vazhdimësi.	K2 2023
3.	IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit që të veprojë konform rregullave në fuqi sa i përket Zyrtarit të Bazës së të Dhënave, për t'u siguruar se zbatohen politikat e sigurisë së informacionit dhe se i njëjti plotëson kriterin e pajisjes me Leje të sigurisë.	-II-	Është zbatuar.	K2 2023
4	IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit që të shtyjë zyrtarët policor të jenë të pajisur me të gjitha pajisjet e autorizuar, duke e konsideruar kontrollin e vazhdueshëm si një metodë efektive të ushtrimit të mbikëqyrjes.	-I-	Ushtrim i kontrollit dhe mbikëqyrjes nga stafi menaxhues i stacionit.	K2 2023
5.	Për arsye sigurie, IPK i rekomandon Drejtorisë së Logjistikës që të përkujdeset në furnizimin e Stacionit me jelek anti-plumb dhe sprej, pasi që për kohë të gjatë ato janë me afat të skaduar.	-I-	Janë adresuar kërkesat në Drejtorinë e Logjistikës.	K2 2023
6.	IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit që të ndërmarrë veprimet e nevojshme për t'u siguruar se Sektori i Resurseve mbanë evidencë mbi trajnimet e brendshme dhe të ricertifikimit.	-I-	Ka filluar zbatimin konform rekomandimit/është caktuar përkohësisht Z/policor.	K2 2023
7.	IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit që trajtimi i rasteve në nivel Stacioni për shkelje të lehta disiplinore të realizohet brenda afateve të përcaktuara të hetimit dhe vendosjes.	-I-	Të ushtrohet kontroll dhe monitorim i vazhdueshëm në respektimin e afateve kohore.	K2 2023
8.	IPK-ja u rekomandon Komandantit të Stacionit, Shefit të Operativës, mbikëqyrësve të ndërrimit që të organizojnë kontrole të vazhdueshme në Bazën e radio-komunikimit për ngritjen e cilësisë së evidencës së logut operacional.	-I-	Shtim i kontrollit nga Komandanti i Stacionit dhe Operativa e Stacionit në drejtim të rritjes së cilësisë.	K2 2023
9.	IPK-ja i rekomandon menaxhmentit të Stacionit që të hartojë plane operative për parandalimin e luftimit të veprave kriminale, si dhe që adresojnë shqetësime a dukuritë negative brenda shoqërisë, të pasqyruara në raportet vjetore.	-I-	Hartim të PO sipas nevojave /trendit të kriminit.	K2 2023
10.	IPK-ja i rekomandon menaxhmentit të Stacionit që gjithnjë pas përfundimit të	-I-	Operativa përpilon raport pas operacional/ mbi	K2 2023

	<i>planeve operative, të analizojë dhe vlerësojë aktivitetet e ndërmarra, sfidat që vështirësojnë arritjen e objektivave të vëna dhe të hartojë raporte pas operative.</i>		<i>vështirësitë, të arriturat dhe sfidat.</i>	
11.	<i>IPK-ja i rekomandon menaxhmentit të Stacionit që të ushtrojë kontroll më efikas mbi zyrtarët policor dhe njësitë, që veprimet fillestare në realizimin e urdhëresave të mos jenë të shtyra në kohë, si dhe të shtojnë përpjekjet në marrjen e më shumë veprimeve drejt realizimit të tyre.</i>	<i>-I-</i>	<i>Përgatitje PO nga Operativa drejt realizimit të urdhëresave/ monitorim i vazhdueshëm në raport me kohën e parashkrimit.</i>	<i>K2 2023</i>
12.	<i>IPK-ja i rekomandon Shefit të Hetimeve dhe hetuesve, të cilët trajtojnë rastet e dhunës në familje, që t'i kushtojnë kujdes më të shtuar "Vlerësimin të rrezikut për viktimën" dhe që ky proces të mos jetë formal, por i mirëfilltë dhe i realizuar në bashkëpunim me palët.</i>	<i>-I-</i>	<i>Ushtrim, kontroll i shtuar mbi sektorin e hetimeve/ respektivisht hetuesin e Dhunës ne Familje.</i>	<i>K2 2023</i>
13.	<i>IPK-ja i rekomandon Shefit të Hetimeve që të ushtroj kontroll të shtuar mbi hetuesit, që gjatë intervistimit të palëve të parashtrajnë numër më të madh të pyetjeve lidhur me rastet dhe në konsultim me Prokurorin e Shtetit, intervistat të përfshijnë edhe dëshmitarë tjerë potencial, që mund t'i kontribuojnë zbardhjes së rasteve. Po ashtu, të ushtrohet mbikëqyrje e duhur edhe në ngritjen cilësore të kallëzimeve penale.</i>	<i>-I-</i>	<i>Kontroll mbi hetuesit në drejtim të rritjes së cilësisë së hetimit gjatë trajtimit të rasteve.</i>	<i>K2 2023</i>
14.	<i>IPK-ja i rekomandon Sektorit të Hetimeve që nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se një vepër penale është kryer, të dorëzojë kallëzim penal Prokurorit kompetent brenda tridhjetë (30) ditëve pas veprimit të fundit hetimor, i cili vendosë më tutje nëse do të iniciojë procedurën penale (neni 82, paragrafi 5 i KPP-së).</i>	<i>-I-</i>	<i>Të respektohet afati kohor për procedim/ referuar KPP.</i>	<i>K2 2023</i>
15.	<i>IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit dhe Shefit të Sektorit të Hetimeve që në drejtim të ushtrimit të kontrollit adekuat mbi lëndët, të respektohet procedura për procedim të rasteve në Prokurori konform Procedurës Standarde të Operimit-Procedimi i lëndëve dhe kompetenca lëndore të hetimit, duke ndjekur rregullin që kallëzimet penale të kalojnë përmes hetuesit të lëndës, tek mbikëqyrësi i vijës së parë dhe më pas tek Shefi i Sektorit të Hetimeve.</i>	<i>-I-</i>	<i>Respektimi i PSO-së DPPK-01/0475/2020.</i>	<i>K2 2023</i>
16.	<i>IPK-ja i rekomandon Zyrtarit përgjegjës të Dhomës së dëshmive në kuadër të Stacionit, që me rastin e pranimit të dëshmive nga hetuesit e rasteve, të sigurohet se dëshmitë ruhen në vende të</i>	<i>-I-</i>	<i>Të zbatohet PSO-ZDPO-02/008/14.</i>	<i>K2 2023</i>

	<i>posaçme, varësisht prej specifikave të tyre, me qëllim të ruajtjes nga dëmtimet.</i>			
17.	<i>IPK-ja i rekomandon Zyrtarit përgjegjës të Dhomës së dëshmime që në asnjë rast të mos pranojë/mbajë sende që nuk janë sekuestruar apo konfiskuar konform dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.</i>	-I-	<i>Të zbatohet PSO-ZDPO-02/008/14.</i>	<i>K2 2023</i>
18.	<i>IPK-ja i rekomandon Zyrtarit përgjegjës të Dhomës së dëshmime që të tregojë përkushtimin e nevojshëm në ruajtjen dhe administrimin e duhur të dosjeve që lidhen me dëshmitë, si dhe sistemojë/vendosë dëshmitë në atë mënyrë që ato të jenë lehtë të identifikueshme sipas një sistemi të qartë numerik, të evidentuar në regjistër dhe databazë.</i>	-I-	<i>Të zbatohet PSO-ZDPO-02/008/14.</i> <i>Kontroll i shtuar nga Shefi i Hetimeve/Shefi i Operativës dhe Komandanti i Stacionit.</i>	<i>K2 2023</i>
19.	<i>IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit që në Dhomën e dëshmime të ushtrohen kontrole të brendshme përmes revizionit, inventarizimit, apo edhe inspektime të pa paralajmëruara, drejt administrimit të duhur të dëshmime dhe Dhomës ku ruhen ato.</i>	-I-	<i>Të zbatohet PSO-ZDPO-02/008/14.</i>	<i>K2 2023</i>
20.	<i>IPK-ja i rekomandon Zyrtarit që kujdeset për automjetet, të evidentoj mungesën e pajisjeve rezervë dhe shtesë në automjete zyrtare dhe në koordinim me Drejtorinë e Logjistikës (Flotën Operative), të sigurojnë furnizimin me pajisje e nevojshme.</i>	-II-	<i>Janë proceduar kërkesat/kontroll i shtuar-inspektim dhe procedim kërkesave në vazhdimësi.</i>	<i>K2 2023</i>
21.	<i>IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit që në koordinim me Drejtorinë e Logjistikës të sigurojnë shërbimet e kontraktuar për mbushje e pajisjeve kundër zjarrit, për të siguruar se pajisjet e tilla janë në gjendje funksionale në rast fatkeqësish.</i>	-I-	<i>Inspektim i pajisjeve dhe ngritja e kërkesave urgjente sipas nevojës.</i>	<i>K2 2023</i>
22.	<i>IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit që në koordinim me shërbimet mbështetëse të Policisë të adresojnë çështjen e pastërtisë, për të krijuar ambient të pastër brenda Qendrës së Ndalimit.</i>	-I-	<i>Kontroll/monitorim i shtuar në raport me pastërtinë në QN.</i>	<i>K2 2023</i>

Shtojcat

Tabela nr. 1 - Pasqyrë mbi burimet njerëzore të Stacionit Policor të Obiliqit (kategoria B)			
Kategoria	Burimet njerëzore të planifikuara	Gjendja më 31 dhjetor 2022	Gjendja më 27 shkurt 2023
Personel i uniformuar	46	56 (+10)	59 (+13)
Shërbyes civil	10	7 (-3)	6 (-4)
Gjithsej	56	63 (+7)	65 (+9)

Tabela nr. 2 - Pasqyrë mbi treguesit e performancës lidhur me reagimin në thirrjet e qytetarëve			
Treguesi (indikatori)	Matjet për stacionet (2022)	Matjet për Obiliq (2022)	Matjet për Obiliqin (2023)
Numri i mostrave	15.105	327	265
Koha e përgjithshme e reagimit policor	13.76	14.16	13.86
Koha e ndarjes së detyrës	2.15	1.82	1.89
Koha e daljes në vendngjarje	11.61	12.34	11.97
Koha e reagimit në zonë urbane	11.62	10.79	9.97
Koha e reagimit në zonë rurale	20.79	17.68	17.97
Përqindja e reagimit me kohë	80.05	83.18	84.15
Përqindja e reagimit me vonesë	19.95	16.82	15.85
Koha e reagimit në thirrjet e tipit “aksident”	11.42	11.91	11.61
Koha e reagimit në thirrjet e tipit “komunikacion”	13.28	13.55	15.47
Koha e reagimit në thirrjet e tipit “incident”	13.95	13.23	13.49
Koha e reagimit në thirrjet e tipit “vepër penale”	17.04	18.09	17.07
Koha e reagimit në thirrjet e tipit “tjera”	13.69	10.00	10.64

Tabela nr. 3 - Pasqyrë mbi treguesit e performancës lidhur me ekzekutimin e urdhëresave		
Treguesi (indikatori)	Viti 2021	Viti 2022
Numri i urdhëresave të bartura nga viti paraprak	110	50
Numri i urdhëresave të pranuar gjatë vitit	246	358
Numri i urdhëresave të realizuara në vitin përkatës	291	327
Numri i urdhëresave të parashkruara	15	15
Numri i urdhëresave të mbetura	50	66
Kuota e realizimit të urdhëresave në raport me stacionet tjera	82% (73%)	80% (76%)
Kuota e parashkrimit të urdhëresave në raport me stacionet tjera	4% (10%)	4% (3%)
Kuota e urdhëresave të mbetura në raport me stacionet tjera	14% (18%)	16% (21%)
Ngarkesa e policëve me urdhëresa në raport me stacionet tjera	6 (8)	7 (7)
Efektiviteti në realizimin e urdhëresave në raport me stacionet	5 (6)	6 (6)
Kuota e realizimit të urdhëresave për polic	83% (73%)	80% (76%)

Tabela nr. 4 - Pasqyrë mbi treguesit e performancës lidhur me patrullimet dhe gjobat e trafikut		
Treguesi (indikatori)	Viti 2021	Viti 2022
Numri i patrullimeve në këmbë	2.580	3.589
Mesatarja e patrullimeve në raport me mesataren e përgjithshme (për ditë)	7 (4)	10 (4)
Numri i patrullimeve me automjet	764	834
Mesatarja e patrullimeve në raport me mesataren e përgjithshme (për ditë)	2 (6)	2 (7)
Numri i pikave të kontrollit	1.663	2.818
Mesatarja e pikave në raport me mesataren e përgjithshme (për ditë)	5 (8)	8 (8)
Numri i gjobave të shqiptuara	5.001	2.702
Mesatarja e gjobave në raport me mesataren e përgjithshme (për ditë)	14 (16)	7 (21)
Mesatarja e gjobave për polic në raport me mesataren e përgjithshme (për vit)	81 (64)	48 (98)

Tabela nr. 5 - Pasqyrë tabelore mbi angazhimet në mbledhjen e informatave inteligjente		
Indikatorët e performancës	Viti 2021	Viti 2022
Numri i informatave inteligjente të dërguara nga Stacioni	183	168
Numri i përgjithshëm i informatave inteligjente të 37 stacioneve	6.679	12.306
Numri i punonjësve të uniformuar të Stacionit	62	56
Numri i informatave për zyrtar policor në raport me mesataren e stacioneve	3 (2)	3 (4)

Tabela nr. 6 - Pasqyrë tabelore mbi indikatorët e performancës në hetimin dhe zbulimin e krimit		
Indikatorët e performancës	Viti 2021	Viti 2022
Numri i veprave penale	372	402
% e zbulueshmërisë së stacionit në raport me mesataren për stacione	62.1 (61.3)	57.5 (63.4)